



6 QERSHOR-5 KORRIK, 2016

**NË LUTJE ME BESIM, SHPRESË
DHE DASHURI PËR BOTËN MYSLIMANE**

30 DITËT

ELUTJES

PËR BOTËN MYSLIMANE

Përmbajtja

Fokusi ynë	
Ku jemi duke u lutur?	2
Çfarë është Ramazani?	3
Kur është Ramazani?	4
Diçka po ndodh	5
Ditët 1-30: Fillojnë pikat e lutjes	6
Milliona njerëz në lëvizje	7
Hapa praktikë për të dashur Myslimanët	39
Vazhdoni të luteni përgjatë gjithë vitit	40

Mirë se erdhët në 30 ditët e Lutjes, 2016!

Të dashur miq lutës,

Vitin e kaluar, kemi patur më shumë se kurrë më parë pjesëmarrës në 30 Ditët e Lutjes për Botën myslimane! Historitë e cituara nga kërkuesi David Garrison, nga libri i tij, *Një erë në Shtëpinë e Islamit (A Wind in the House of Islam)* na tregoi se sa të efektshme kanë qenë lutjet tona. Ne kemi edhe artikuj të tjerë nga Davidi këtë vit ndërsa vazhdojmë të eksplorojmë Nëntë Dhomat e Shtëpisë së Islamit për të parë se ku janë duke ndodhur lëvizjet për Krishtin nëpër botën myslimane.

Ka shumë lloje lëvizjesh brenda botës myslimane. Lufta dhe terrorizmi kanë bërë që miliona myslimanë të arratisen prej shtëpive të tyre në kërkim të një strehimi të sigurtë në kombe të tjera. Kjo mund të krijojë një mundësi për të takuar Jezusin në një tokë të re. Duke parë tragjedi të tilla, mund të ndodhë që dhe myslimanë të tjerë të ndërmarrin një tjetër lloj udhëtimi – një udhëtim besimi ndërsa vënë në pikëpyetje çfarë besojnë dhe pse. Ne lutemi edhe për ata myslimanë që nuk e kanë dëgjuar kurrë historinë e Jezusit.

Shpresojmë që do të udhëtoni me ne përqark botës me lutjet tuaja për botën myslimane dhe do të bëheni më aktivë në të kuptuarit tuaj të dashurisë së Perëndisë për myslimantët.

Ju faleminderit që luteni!

Redaktorët, *30 ditët e Lutjes ndërkombëtare*

30 ditët e lutjes për botën myslimane: Duke inkurajuar, edukuar dhe aftësuar që nga viti 1993.

Çështjet e botës myslimane mund të ndryshojnë çdo vit, por Udhëzuesi i Lutjes për 30 Ditët e Lutjes për Botën myslimane gjithmonë synon që t'ju inkurajojë, edukojë dhe aftësojë në lutjet tuaja për ta. Kjo është mënyra se si ne e ndjekim Jezusin në urdhërimin e Tij për ta dashur të afërmin tonë.

Duke inkurajuar

30 Ditët filloi me një grup njerëzish që dëshironin të shihnin myslimanët në të njëjtën mënyrë si Perëndia i sheh ata. 30 Ditët i inkurajon besimtarët që të luten që Perëndia të drejtojë lutjet e tyre me njohjen e Tij të dashurisë për ta.

Duke edukuar

Është e rëndësishme që të jemi të mençur në mënyrën se ku e marrim informacionin tonë mbi botën myslimane. 30 Ditët e merr përmbajtjen e vet nga njerëz që kanë jetuar mes myslimanëve dhe kanë për qëllim që t'i bekojnë ata. Ne mendojmë se mund ta kuptojmë më mirë atë çfarë myslimanët besojnë, kur i dëgjojmë ata dhe t'i ndihmojmë lexuesit tanë që të dallojnë se

sa e larmishme është bota myslimane në kulturat dhe besimet e veta.

Duke aftësuar

Lutja gjatë muajit të Ramazanit i ndihmon të Krishterët që të identifikohen me myslimanët. Gjatë këtij muaji, myslimanët janë duke kërkuar që të njohin Perëndinë më mirë dhe të kenë një kuptim më të mirë të rrugëve të Tij. Lutjet tona i ndihmojnë ata që të bëjnë pikërisht këtë. Kjo është një kohë e mirë për të folur me miqtë tanë myslimanë për ato që Perëndia është duke iu zbuluar juve ndërsa luteni.

Për informacione të mëtejshme në lidhje me lëvizjen 30 Ditët e Lutjes dhe për ide se si mund të lutemi më efektivisht, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit në : www.pray30days.org



Ku jemi duke u lutur?

Shtëpia e Islamit ose "Dar al-Islam" në arabisht, është emri që myslimanët i japin një perandorie të padukshme fetare që shkon nga Afrika Perëndimore deri në Indonezi. Ajo mban 49 kombe dhe 1.6 miliardë myslimanë.

Brenda kësaj "Shtëpie të Islamit" janë 9 zona me identitete të përbashkëta gjeografike dhe kulturore të cilave ne u referohemi në këtë udhëzues si "Dhoma të Shtëpisë së Islamit." Në këto dhoma ne gjejmë që janë duke ndodhur lëvizje të mijëra njerëzve që kthehen në besimin tek Jezusi. Ne do të lutemi dhomë për dhomë, (siç edhe tregohet në hartë) dhe për grupet e popujve që jetojnë në to, përgjatë këtij udhëzuesi:

“...janë duke ndodhur lëvizje të mijëra njerëzve që kthehen në besimin tek Jezusi.



Çfarë është Ramazani?

Islamizmi ka mbi 1.57 miliardë ndjekës dhe ata janë nga kultura shumë të ndryshme në të gjithë botën. Si rezultat, brenda Islamit ka shumë tradita dhe doke të ndryshme. Ashtu si në Krishtërim dhe Judaizëm, praktikat dhe të kuptuarit e myslimanëve për sa i përket besimit të tyre mund të jenë shumë të ndryshme.

Kjo është arsyeja se pse është e rëndësishme të njohim myslimanët dhe çfarë ata besojnë në vend që të hamendësojmë se e dimë për shkak se e kemi parë tek lajmet apo kemi lexuar në internet. Çdo mysliman, ashtu si çdo i krishterë, është në një udhëtimi të vetin të besimit që është i ndikuar nga familjet, kultura dhe përvojat e tyre.

Shumica e myslimanëve do të thoshin se Pesë Shtyllat e Islamit janë të rëndësishme për t'u ndjekur nëse dëshiron të jetosh një jetë të mirë sipas Islamit. Këto Pesë Shtylla janë:

- Shahadah:** recitimi i sinqertë i shpalljes së besimit mysliman
- Salat:** lutja në mënyrën e duhur pesë herë çdo ditë
- Zekati:** dhënia e taksës së lëmoshave (ose bamirësia) në përfitim të të varfërve dhe nevojtarëve
- Saum:** agjërimi gjatë muajit të Ramazanit
- Haxhi:** pelegrinazhi (udhëtimi) në Mekë

Qëllimi i Agjërimit

“Saum” është fjala arabe për “agjërimin” dhe kjo fjalë për fjalë ka kuptimin “të heqësh dorë”. Gjatë Ramazanit, kjo do të thotë jo vetëm të heqësh dorë nga ushqimi dhe të pirët, por edhe nga sjelljet, mendimet dhe fjalët e këqia.

Sipas traditës, gjatë muajit të Ramazanit iu zbulua Kur’ani profetit Muhamed. Myslimanët e shënojnë këtë ngjarje të rëndësishme në besimin e tyre duke agjëruar çdo ditë nga lindja e diellit deri në perëndim të tij. Agjërimi është shumë i rreptë – asnjë lloj ushqimi apo lëngjesh, madje as ujë. Duhani dhe aktiviteti seksual janë të ndaluara, dhe muslimanët duhet të bëjnë një përpjekje më të madhe për të shmangur çdo gjë që është e paligjshme apo e papastër. Kjo lloj praktike përfaqëson përkushtimin e personit ndaj frymës së agjërimit – kjo është një kohë për të praktikuar vetë-ndalimin, për të pastruar si trupin ashtu edhe shpirtin dhe për t’u fokusuar në adhurimin e Zotit.

Gjatë Ramazanit, familje dhe miq mblidhen së bashku për të ndarë ushqimet dhe miqësinë në mbrëmje dhe gjatë natës. myslimanëve u bëhet thirrje që ta përdorin këtë muaj për të shqyrtuar jetët dhe besimin e tyre, për të bërë paqe me njëri tjetrin, për të forcuar lidhjet e tyre me familjet dhe

miqtë, dhe në përgjithësi që të bëhen përpjekje për të qenë një person më i mirë.



Kur është Ramazani?

Muaji i Ramazanit përcaktohet në bazë të kalendarit islamik që është një kalendar hënor. Kjo do të thotë që Ramazani lëviz me kalendarin Gregorian afërsisht me 11 ditë çdo vit. Data e Ramazanit mund të variojë gjithashtu edhe nga vendi në vend në varësi të asaj nëse është shfaqur hëna apo jo.

Myslimanët besnikë ngrihen para lindjes së diellit dhe hanë një vakt, *Syfyryn*, para agimit dhe lutjeve të para. Ata nuk hanë më deri mbas perëndimit të diellit kur e thyejnë agjërimin me një vakt që quhet *Iftar*. Ata që janë të moshuar apo të sëmurë, fëmijët e vegjël dhe gratë shtatzëna apo me fëmijë në gjì nuk janë të detyruar të agjërojnë.

Pse të lutemi gjatë Ramazanit?

30 Ditët e lutjes bëhen gjatë muajit islamik të Ramazanit për shkak se kjo është një kohë kur edhe vetë myslimanët janë duke u lutur. Të Krishterët shohin një lidhje me myslimanët në praktikën tonë të përbashkët të agjërimit dhe lutjes – dhe thyerja e agjërimit së bashku me ta është një mundësi e mirë për të njohur njëri -tjetrin më mirë!

Të krishterët mund të frymëzohen për t'i marrë lutjet e tyre më seriozisht ndërsa shohin fqinjët e tyre myslimanë duke agjëruar dhe aktivë gjatë Ramazanit. Ne shpresojmë që kjo do të ofrojë momente kur mund të flitet me njëri- tjetrin mbi besimin dhe për të ardhur në një kuptim më të mirë të udhëtimit në të cilin gjendemi drejt njohjes së Perëndisë.

Gjëja më e rëndësishme është të mos hamendësoni, nëse jeni duke njohur Myslimanët.



Diçka po ndodh

Çdo ditë dëgjojmë në lajme për ISIS apo Al- Kaedën apo Boko Haram – grupe Islamike radikale që shkaktojnë terror dhe shkatërrim dhe ndryshojnë historinë për mijëra njerëz. Por, ka një histori më të madhe që po ndodh në botën myslimane ditët e sotme.

Islamizmi është feja më shpejt e përhapur në botë sot. Çdo vit, më shumë se 37 milionë njerëz i shtohen botës myslimane - shumica kryesisht nga shpejtësia e lartë e lindjeve. Studiuesit mendojnë se nga 2030 Islami do ketë mbi 2 miliardë ndjekës dhe nga 2050 do ketë më shumë myslimanë se të krishterë. Megjithatë, po ndodh edhe diçka tjetër por që nuk po raportohet në lajme! Myslimanët po kthehen në besimin tek Jezu Krishti!

Që nga fillimet e Islamit në vitin 622 pas Krishtit, të krishterët janë përpjekur të sfidojnë rritjen e Islamit me anë të forcës ushtarake dhe punës misionare. Deri tani, asnjë nga këto metoda nuk ka qenë e suksesshme.

Për 700 vitet e para të Islamit ,ka vetëm tre raporte të kthimit të paktën të një mijë myslimanëve në të krishterë. Për 500 vite të tjera nuk kishte fare lëvizje të tilla. Madje, në të kundërt Islami u rrit shumë shpejt në vende si: Lindja e Mesme, Afrika e Veriut dhe Europa Lindore deri tani.

Në fund të shekullit të 19-të, 10 - 20 000 myslimanë në Indonezi u pagëzuan në besimin e krishterë. Më pas ndodhën edhe dy lëvizje tjera në Afrikën Lindore dhe Amerikën Veriore. Më pas, papritur midis viteve , dhjetëra mijëra myslimanë në Indonezi, Bangladesh, Iran, Algjeri dhe Azinë Qendrore vendosën të ndiqnin Krishtin.

Megjithatë, vetëm në këtë shekull ka ndodhur kthimi më i madh i myslimanëve në të krishterë në gjithë historinë. Që nga 2001, ka patur rreth 72 lëvizje, secila me të paktën një mijë myslimanë që janë kthyer tek Krishti, duke llogaritur qindra mijëra në total. Nuk është koincidence që kjo gjë ka ndodhur në të njëjtën kohë me këtë lëvizje lutjeje – 30 Ditët e Lutjes për Botën Myslimane.


Këtë vit vazhdojmë të lutemi mbi Shtëpinë e Islamit dhe kërkojmë që të pajisemi më mirë për të kuptuar dhe për të shtuar këtë lëvizje të madhe të myslimanëve në familjen e Krishtit.



...vetëm në këtë shekull ka ndodhur kthimi më i madh i myslimanëve në të krishterë në gjithë historinë. Që nga 2001, ka patur rreth 72 lëvizje, secila me të paktën një mijë myslimanë që janë kthyer tek Krishti, duke llogaritur qindra mijëra në total.



Lëvizjet e myslimanëve drejt Krishtit



Mënyra të reja për lëvizje të reja

Pas 13 shekujve të parë Islamizmi pati vetëm pak lëvizje në Krishtin. Por, në 150 vitet e fundit kemi parë 82 lëvizje me nga të paktën një mijë myslimanë që vendosin besimin e tyre tek Krishti, disa madje numërojnë qindra dhe mijëra besimtarë të rinj. Pse po ndodh kjo gjë tani? Çfarë ka ndodhur?

Për shekuj me radhë, të krishterët janë përpjekur t'u ofrojnë myslimanëve një fe më të mirë. Por myslimanët kanë një fe mjaft më të mirë vetë. Ata, ashtu si ne, e dinë që feja nuk të ofron shpëtimin.

Të krishterët kanë bërë përpjekje që të shtrijnë besimin edhe nëpërmjet mjeteve ushtarake. Megjithatë, ushtritë myslimane janë të përgatitura më mirë për luftë, nga ana kulturore dhe fetare, ndërsa ushtritë e krishtera duhet të përballen me atë që Jezusi tha, "Duajini armiq të tuaj" (Mateu 5:44). Ushtritë e krishtera dështuan në Kryqëzatat e mesjetës dhe patën avancime të përkohshme në shekullin e 19 –të, epokën e kolonive. Sot, shumica e të krishterëve e pranojnë që pushtimet ushtarake nuk janë pjesë e përparimit të Mbretërisë së Perëndisë.

Ditët e sotme të krishterët takohen me burra e gra myslimanë, si njerëz që janë të njëjtë me ne, të humbur pa një Shpëtimtar.

Ata po kërkojnë të fitojnë zemra dhe mendje për Atë, Mbretëria e të cilit nuk është e kësaj tokë.

Po ashtu, misionarët po mësojnë që nuk është feja jonë që ofron shpëtimin për myslimanët; është Zoti ynë! Dëshmitë e



Ditët e sotme të krishterët takohen me burra e gra myslimanë.



besimtarëve që vijnë nga origjinë myslimane nga Afrika e Veriut në Indo – Malajzi, zbulojnë një temë të përbashkët. Nuk është feja jonë, politikat tona, ekonomia jonë apo qytetërimi ynë që po i nxit ata të dorëzojnë jetët e tyre një besimi të ri, është vetë Zoti Jezus Krisht.

LE TË LUTEMI

- ◆ Që të krishterët e sotëm do të ndjekin shembullin e Krishtit ndërsa duan të

përparojë Mbretëria e Tij – jo me anë të forcës as me anë të fuqisë, por me anë të Frymës së Tij (Zakaria 4:6)

- ◆ Që të Krishterët e sotëm do të ndjekin shembullin e Jezusit i cili, edhe pse "kishte natyrën e Perëndisë, e zbrazi veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori." (Fil. 2:6-7)
- ◆ Që nuk do ndjekim strategji të dështuara si në të kaluarën, por do të lartësojmë personin e Jezu Krishtit i cili është plotësisht i aftë të tërheqë gjithë njerëzit, përfshirë myslimanët , drejt vetes së tij.

Afrika Veriore: Qengji i Perëndisë

Afrika e Veriut ka qenë atdheu i Krishtëritimit për shekuj përpara se ushtritë islamike ta pushtonin atë në shekullin e 7-të. Sot, Afrika e Veriut ka më shumë se 100



milionë myslimanë të cilët përbëjnë 98-100 për qind të popullsisë në Mauritani, Saharanë Perëndimore, Marok, Algjeri, Tunizi dhe Libi.

Që nga shkëputja e Afrikës së Veriut nga kolonizimi Evropian në shekullin e 20-të, qeveritë Afrikano Veriore kanë

përdorur kulturën Arabe, përfshirë këtu Islamin, për të bashkuar kombet e tyre ndaj ndikimeve të mëtejshme nga të huajt.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve ndodhet një popullsi autoktone Berber kokëfortë të cilët pretendojnë që janë më të lashtë dhe që Afrika e Veriut është atdheu i tyre.

Edhe pse kanë qenë të shtypur për shekuj, në Afrikën e Veriut gjenden akoma të paktën

19 grupe të veçanta të popullsisë Berber me 30-40 milionë folës të gjuhëve Berber. Këto variojnë nga Marokenë Riffi (4-6 milionë) dhe Berberët Kabilë Algjerianë (5-6 milionë) në veri, tek Tuaregët Nomadë (1.2 milionë) të shkretëtirës së Saharasë.

Në Afrikën e Veriut ka shumë kisha të reja edhe pse është e vështirë të numërohen të gjitha.

Ndërsa kam udhëtuar përmes fshatrave të maleve Berber, shpesh kam parë piktura të kornizuara që japin Jezusin si Bariu i

Mirë. Poshtë këtyre imazheve ishin fjalët e shkruara në një kishë lokale në gjuhën Berber: *"Bariu i mirë e jep jetën e tij për delet"*. Një grua Berberiane që quhej Zeinab më shpjegoi, "Bariu ka një domethënie të veçantë për ne sepse ne mbajmë dele. Ne e dimë mirë sa duhet t'i dojë bariu delet dhe si duhet t'i mbajë afër zemrës së tij."

Këta besimtarë Berberianë, nuk janë më dele pa bari. Ata e kanë gjetur tashmë Bariun e tyre dhe po dëgjojnë zërin e tij.

LE TË LUTEMI

- ◆ Që lëvizjet e krishtera në Afrikën e Veriut do vazhdojnë pavarësisht shtypjeve.
- ◆ Që përkthimet e reja të mesazhit të Ungjillit në gjuhët Berberiane do të zgjojnë besimin në popullsinë autoktone në Afrikën e Veriut.
- ◆ Përkthimi i shkrimeve, radio dhe televizionet satelitore dhe dëshmia e besimtarëve po kontribuojnë në një rizbulim të një besimi të ri, por po ashtu të lashtë të krishterë në Afrikën e Veriut. Të lutemi për punëtorët që japin këto mesazhe.

AFRIKA VERIORE

Kombe	6
Grupe myslimane	82
Popullsia	100,631,350
Popullsia myslimane	99,029,643

Maurët e Mauritanisë

Mauritania është një komb me popullsi Arabe, Berbere dhe grupin e Afrikanëve me ngjyrë të gjithë së bashku. Afërsisht 70% e popullsisë flasin gjuhën Hasania dhe i përkasin grupit të Maurëve Arabo – Berberë. Njëra gjysëm e këtij grupi quhen *Maurët e bardhë* dhe përbëhen kryesisht nga tregtarë, aristokratë, akademikë dhe elita tjera. *Maurët e zinj* ose me ngjyrë , gjysma tjetër, janë pasardhës të sklllevërve nga Afrika e Zezë. Pjesa tjetër e mbetur, 30% e popullsisë përfaqëson popuj të ndryshëm Afrikanë me ngjyrë që jetojnë kryesisht në Jug dhe në kryeqytet.

Në vitin 1957, 90% e Maurëve jetonin akoma në çadra dhe qytetet e mëdha nuk ekzistonin. Një thatësi e rrallë në vitin 1970 i detyroi shumë prej tyre të shisnin bagëtinë që kishte mbijetuar dhe të shpërnguleshin në qytete të cilat kanë qenë gjithnjë e në rritje që nga ajo kohë.

Arabët e përhapën islamizmin në Sahara në shekullin e 8-të, gjë e cila e dobësoi influencën Berbere. Në vitin 1920 Mauritania u bë republikë Franceze dhe arriti pavarësinë si shtet me juridiksion islamik në vitin 1960.

Revolucionet në vendet islamike e kanë bërë popullsinë të shqyrtojë ligjet islamike me shumë kujdes. Për shumicën e tyre kjo duket sikur është zgjidhja ndaj problemeve si varfëria, skllavëria, padrejtësia, thatësira etj. Megjithatë, nga ana shoqërore shumë prej tyre bëjnë jetë nomadësh; preferojnë të ulen në qilim sesa në karrige, janë pak të vëmendshëm ndaj rregullave të trafikut; shpesh martohen dhe ndahen disa herë.

Në ditët e sotme popullsia e Mauritanisë është pothuajse 100 % myslimanë Suni dhe ka vetëm pak të krishterë në vend.

LE TË LUTEMI

- ◆ Që ky popull dikur nomad të gjejnë rrugën për tek Jezusi.
- ◆ Për ata besimtarë që Perëndia i ka hirruar të tregojnë dashurinë e Tij tek populli i Mauritanisë.
- ◆ Që besimtarët e rinj Maurë do rriten e forcohen në besimin e tyre dhe në kurajën për të ndarë këtë besim



shkollave të krishtera, projekte të zhvillimit të komunitetit dhe jetimoreve apo edhe të drejtësisë sociale për të cilën ata e kërkojnë shumë dhe e gjejnë në komunitetet e

pyet, “Çfarë mund të na thuash për Jezusin” ai u përgjigj, “Kur’ani thotë që nëse dyshon për diçka, pyet ata që kanë qenë para teje.” Unë e shoh Jezusin si personi që ka hequr gjithë dyshimet e mia. Jezusi është ai që thotë që nuk mund të vish tek Ati përveçse nëpërmjet Tij. Unë e pranoj që: Ai është e vërteta dhe jeta.”

Dikush tjetër ofroi këtë dëshmi: “ Si myslimanë ,gjithçka që kemi bërë kanë qenë pesë lutje përmendësh,por nuk kishim sigurinë e jetës së përjetëshme. Askush nuk mund të më jepte një përgjigje të duhur. Kjo gjë, më nxiti të kërkoj në atë kush Jezusi është.”

Sapo myslimanët takojnë Krishtin, qoftë me anë të përgjigjes së lutjeve, ëndrrave apo leximit të shkrimeve , ata gjejnë një Zot të gjallë të cilin nuk mund ta injorojnë dhe për të cilin janë gati të japin jetët e tyre.

LE TË LUTEMI

- ◆ Që në lëvizjet në Krishtin në Afrikën e Perëndimore besimtarët do të thellohen dhe forcohen në besimin e tyre të ri.
- ◆ Për mbrojtje nga forcat e errësirës në Boko Haram, fetë fisnore dhe padrejtësitë sociale.
- ◆ Janë më shumë se 100 milionë myslimanë në Afrikën Perëndimore. Të lutemi për ata që janë të paditur për realitetin e Krishtit veçanërisht në këtë rajon të larmishëm.

Afrika Perëndimore: rëndësia e vetëzbulimit

Në shtëpinë e Islamit , Dhoma e Afrikës Perëndimore është një fushë beteje midis myslimanëve të Saharasë , të krishterëve përgjatë bregut dhe një armiqësi e vazhdueshme shihet tek të dyja palët. Si për myslimanët dhe të krishterët në Afrikën Perëndimore, feja fisnore ka një ndikim të madh. Ata duan të dinë cila fe është e fuqishme mjaftueshëm që t’i mbrojë nga forcat frymërore që shohin rreth tyre.

Myslimanët në Afrikën Perëndimore po tërhiqen tek Krishti me mënyra të ndryshme. Ata flasin për vitalitetin e komuniteteve të Krishtera, impaktin e

krishtera. Mbështetja e secilës prej këtyre është edhe lutja gjithë natën për të cilën njihen edhe të krishterët e Afrikës Perëndimore.

Shumë myslimanë të konvertuar shpjegojnë së është i kuptuari i tyre personal për atë kush është Krishti që i ndihmon ata. Kur’ani mund të prezantohet vetëm në gjuhën arabe ndërsa Bibla

përkthehet në gjuhët lokale në mënyrë të vazhdueshme. Shumë besimtarë që vijnë nga sfond mysliman

komentojnë, “Nuk kuptoj arabisht as Kur’anin, por Biblën e kuptoj. “ Kur një besimtar i ri nga sfond mysliman u



AFRIKA PERËNDIMORE

Kombe	18
Grupe myslimane	514
Popullsia	335,556,076
Popullsia myslimane	105,239,092

Djemtë garibou të Afrikës Perëndimore

Ajo që nisi si një mënyrë për t'u mësuar djemve vlerat Islamike dhe mësimin përmendësh të Kur'an-it është kthyer në një program të rrezikshëm për



Djemve Garibou iu hiqet e drejta për të patur një fëmijëri.



shfrytëzimin dhe skllavërinë e fëmijëve në disa pjesë të Afrikës Perëndimore. Djemtë Garibou apo Talibe gjenden në qytete të Afrikës Perëndimore si Mali, Senegal, Burkina Faso, apo Guinea Bisau. Këta janë djem, të cilët janë dërguar nga prindërit, për t'u përgatitur në mësimin e Kur'an-it me një mjeshtër apo "marabout". Djemtë duhet të mësojnë të gjithë Kur'an-in në arabisht (një gjuhë të cilën ata nuk e kuptojnë) deri në moshën 19 vjeçare. Duke lypur çdo ditë për

ushqim dhe para (për të përmbushur kuotat që i duhen dhënë marabout), ata mësojnë durimin, përluljen, vuajtjen dhe sjelljet e mira. Gjatë stinës së mbjelljeve, fëmijët punësohen nga fermerët; mësuesi marabout merr të

gjitha të ardhurat financiare.

Nëse

fëmija nuk arrin t'i pëlqejë mësuesit apo të bëjë punën e tij, ai ndëshkohet me abuzim fizik. Djemtë jetojnë në frikë, sëmundjet lihen të pakuruara, abuzimi seksual është një kërcënim i pranishëm, ndërsa lypin rrugëve janë të rrezikuar nga aksidentet rrugore.

Ka edhe trafikim të fëmijëve nga ana e personave që duhet t'i shoqërojnë nga një vend në tjetrin. Në Mars të vitit 2015, 2 të rritur u arrestuan nga Guinea Bisau ndërsa trafikonin 54 fëmijë në Dakar. Statistikat janë të ndryshme dhe është e vështirë të marrësh konfirmime por të paktën 100.000 fëmijë ndikohen nga këto praktika. Qeveritë, të cilat gjenden nën trysinë e udhëheqësve fetarë, nuk janë të afta të veprojnë sipas ligjeve që do t'i mbronin këta fëmijë.

Djemve Garibou iu hiqet e drejta për të patur një fëmijëri. Nëse arrijnë të arratisen nga kontrolli i marabout, ata preferojnë të jetojnë nëpër rrugë, duke ditur se nëse kthehen në familjet e tyre ata do të kthehen sërish tek vendi i vuajtjeve nga i cili janë larguar.



LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni që qeveritë Afrikano-Perëndimore të zbatojnë me rreptësi ligjet që ndihmojnë të drejtat dhe edukimin e këtyre djemve. Lutuni që raportimet për abuzimet e marabout-ëve të hetohen dhe të trajtohen me drejtësi.
- ◆ Ky sistem rajonal i mësimin të Kur'an-it në fillim ka qenë ndryshe. Tani, bazohet në përfitimet financiare të marabout-ëve të rremë e të paskrupuj. Lutuni që *maraboutët* me qëllime të liga të ekspozohen dhe të vihen para drejtësisë.
- ◆ Lutuni për ata që duan të ndihmojnë me djemtë Garibou dhe që të hapen më shumë qendra që sigurojnë banim, përkujdesje mjekësore, ushqyerje të rregullt, dashuri dhe edukim, për djemtë që arratisen nga këto situata abuzive.

Afrika Lindore: të bëhesh si hienat

Nëntëmbëdhjetë kombet e hapësirës së Afrikës Lindore shtrihen nga jugu i Sudanit deri në Afrikën e Jugut. Tregtarët Arabë zotëronin tregtinë e skllëvërve dhe të fildishit derisa Europeanët arritën në shekullin e 16-të duke sjellë me vete misionarë të krishterë. Që nga ajo kohë, Islami dhe Krishtërimi kanë konkuruar me fetë e Fiseve Afrikane për shpirtat e 357 milion banorëve të kësaj zone.

Në ditën e Krishtlindjes së vitit 2011, po qëndroja i ulur në dysheme i

EAST AFRICA

Kombe	18
Grupe myslimane	298
Popullsia	357,412,280
Popullsia myslimane	78,359,098

rrethuar nga 20 udhëheqës myslimanë që ishin mbledhur për të marrë trajnim për besimin e krishterë të cilin sapo e

kishin përqaftuar. Mësuesi i tyre ishte një mesoburrë biznesmen Afrikan nga një prejardhje e krishterë që quhej Jusuf. Jusufi i kishte cilësuar myslimanët në këtë zonë si fusha e tij e misionit dhe

kishte drejtuar shumë prej udhëheqësve të tyre në besim. Kur e pyeta për arsyen e efektshmërisë së tij, Jusufi tha, "Një herë e një kohë përipiqesha t'i bëja të krishterë. Tani përipiqem t'i ndihmoj të vijnë tek Krishti pa përdorimin e përqaftjes fetare."

E pyeta grupin, "Si jeni në gjendja t'a bëni këtë pa persekutim?"

Abu Salam, një burrë në të 30-at, i armatosur me një Testament të Ri në gjuhën arabe, u përgjigj, "Ka persekutim. Qëkur nisa të jap mësim për Isa-në më përzunë nga xhamia. Tashmë e kam çuar çështjen në gjyq. Po mbroj veten si një mysliman që ndjek Isa al-Masih (Jezusin). I kam thënë trupit gjykues, "Kjo është xhamia ime! Përse duhet të largohem prej saj? Kam të drejtë të adhuroj këtu."

Abu Salam tregon një guxim të madh. Në një vend ku mbretëron ligji i Sharias, ai zgjedh të qëndrojë në xhami, Sheiku Abu Salam rrezikon dënimin me

vdekje për krimin e braktisjes së fesë.

"Përse nuk largohesh nga xhamia?" e pyeta, "Cili është përfitimi i të qëndruarit në xhami?"

Disa zëra dhanë përgjigje menjëherë, "Për të arritur të tjerët! Nëse krijomë një komunitet tjetër besimi jashtë xhamisë, do të ketë një hendek ndërmjet nesh dhe të humburve. Në vend që të bëjmë këtë, ne e përfshijmë Jezusin në të gjitha praktikat tona myslimane."

Një grua myslimane foli, "Jezusi erdhi si njeri për të shpëtuar njerëzit, edhe pse ai është Perëndi. Nëse Perëndia do të kishte dashur të shpëtonte "hienat", Ai do të ishte qëndruar pranë tyre. Ne duam të shpëtojmë myslimanët dhe pra na duhet të shkojmë në xhami. Ja pse vëllai dhe motra jonë e vendosin veten në rrezik: për të fituar të tjerët."

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni që ndjekësit e *Isa al-Masih* (Jezusit) në Afrikën Lindore të kenë urtësi dhe kurajo ndërsa jetojnë besimin e tyre në komunitetet vendase.
- ◆ Lutuni për më shumë liri në këtë zonë në mënyrë që njerëzit të mësojnë më shumë rreth besimit dhe ta jetojnë atë pa frikë.
- ◆ 80 milion myslimanë në Afrikën Lindore nuk e njohin akoma Jezu Krishtin – lutuni për më shumë njerëz si Jusufi që do ta quajnë këtë zonë fushën e tyre të misionit.

Afari: udhëtimi në të ardhmen e panjohur

Atdheu i Afarit shtrihet përgjatë bregdetit jugperëndimor të Detit të Kuq, nga jugu i Eritresë përgjatë veriut të Xhibutit, duke u kthyer në Perëndim të Etiopisë Qendrore. Kjo është një zonë e nxehtë dhe e thatë, që përfshin fusha të gjera dhe shkretëtira. Si një popull Nomad, Afarët kanë mësuar të jetojnë në këtë vend shumë të thatë. Ata udhëtojnë nga një tokë e thatë në tjetrën me devetë dhe bagëtinë e tyre, duke jetuar kryesisht me qumështin e kafshëve të tyre.

Historia e këtij populli është transmetuar gojë më gojë, me shumë pak shkrime për ta. Disa nga ata, dëshmojnë për historinë e Afarëve para kohës së Islamizmit. Popujt fqinjë njohin Afarët për guximin e tyre dhe trimërinë e tyre në konflikte. Ata kanë luftuar shumë beteja për të mbrojtur veten dhe vendin e tyre ndaj armiqve të jashtëm.

Por sot, Afarët përballen me kërcënimet nga armiq të rinj: mungesa e kullotave, luftërat civile dhe kufijtë kombëtarë, të cilat pengojnë mënyrat e tyre tradicionale të jetesës. Shumë prej tyre janë zhvendosur në

zonat urbane, ku këta barinj të mëparshëm të guximshëm dhe luftëtarë jetojnë në mesin e popujve të tjerë, si një minoritet me ndikim të vogël politik apo vetëvendosje.

Gjatë dekadave të fundit, disa njerëz prej popullsisë së Afarëve kanë vendosur të ndjekin Krishtin. Ata mblihdhen në grupe të vogla, duke ndriçuar si dritë në këtë vend të errët. Për këtë komunitet të ri, një rritje e ndjekësve të Krishtit, Ungjilli do të thotë shpresë, jo vetëm për veten e tyre, por edhe për gjithë grupin e tyre. Disa prej tyre përballen me persekutim nga familjet dhe klane të ndryshme. Por, pavarësisht nga sfidat, ata me besnikëri ndjekin Krishtin dhe ndajnë Ungjillin pa frikë.

LE TË LUTEMI

- ◆ Për ata pak besimtarë Afarë që të kenë kurajon dhe mençurinë, të ndajnë Krishtin me bashkatdhetarët e tyre.
- ◆ Për Afarët, të cilët Perëndia i krijoi me një identitet të veçantë, të gjejnë mënyra për të festuar identitetin e tyre kulturor në mes të ndryshimit.
- ◆ Mënyra për të komunikuar mesazhin e Jezusit që të zbulohet dhe të ndahet në mënyrë të qartë për këtë popull.



Bota arabe: Ai e dinte. Historia e Amal

Bota arabe është zemra shpirtërore e Islamit. Ajo është vendlindja e Islamit, shtëpia për fjalorët e saj të shenjta, dhe mbrojtësi i Kur'anit të papërkthyesëm i cili është shkruar në shekullin e 7-të. Në ditët e sotme, shumica e Arabëve e gjejnë si të paqartë fjalorin e Kur'anit. Si rezultat i kësaj, shumë muslimanë arabë janë duke kërkuar drejtim nga burime të tjera. I tillë ishte rasti i Amalisë.

Amalia ishte një vajzë Egjiptiane 23-vjeçare, myslimane me një buzëqeshje të bukur. Ashtu si shumë Egjiptianë, ajo është e afrueshme dhe miqësore dhe kurioze për perëndimorët. Kjo e drejtoi atë në një miqësi me një familje të re të krishterë nga Amerika, e cila i tregoi asaj dashurinë e Krishtit dhe e drejtoi atë në besim.

Amalia ka ndarë besimin e saj të ri me nënën e saj e cila e kërcënoi se do ta vriste. E frikësuar se dikush në familje do të bënte këtë gjë, Amalia u largua nga shtëpia dhe gjeti një punë në një hotel turistik, ku ajo u kërcënua nga pronari i saj, se do iu tregojë të tjerëve për ndryshimin e fesë të saj, në

këmbim të mbajtjes së sekretit, I kërkoi asaj favore seksuale. Amalia u largua përsëri dhe u arrestua nga policia. "Na trego se kush të ktheu në këtë besim ty", insistuan ata, "dhe ne do të lëshojmë të shkosh."

Kur e gjeta Amalinë një vit më vonë, ajo ishte fshehur

në shtëpinë e një çifti mirëdashës musliman. I dhashë një Dhiatë të Re dhe i premtova se do ta takoja atë përsëri. Po kërkjoja se çfarë vargu të rëndësishëm në Bibël duhet të ndaja për të inkurajuar këtë motër, të cilës besimi i kishte kushtuar aq shumë. Por Amalia e kishte gjetur atë vetë - ajo tashmë kishte lexuar 10 kapitujt e parë të ungjillit të Mateut.

"Dëgjo këtë", - tha ajo, - "Ruhuni nga njerëzit, sepse do t'ju dorëzojnë në gjykata dhe do t'ju fshikullojnë nëpër sinagogat e tyre. Për shkakun tim do t'ju nxjerrin përpara guvernatorëve dhe mbretërve, që të jepni dëshmi para tyre dhe kombeve. Megjithatë, kur t'ju dorëzojnë, mos jini në ankth se si do të flitni ose ç'do të thoni, mbasi në atë çast do t'ju jepet se ç'keni për të thënë, sepse nuk do të flitni ju, por fryma e Atit tuaj do të flasë nëpërmjet jush. "(Mateu 10: 17-20).


Amalia më buzëqeshi: "Ai e dinte," thërriti ajo, "Jezusi e dinte!" Për Amalinë, kjo ishte e mjaftueshme.

Jezusi e dinte se ku ishte ajo, atë që ajo do të kalonte, dhe se Ai do të ishte gjithmonë me të. Dhe për Amalinë, kjo mjaftonte. "Jezusi është në mua tani," tha ajo, duke treguar zemrën e saj. "Ai nuk do të më braktisë kurrë."

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni për besimtarët me origjinë myslimane si Amalia që vuajnë persekutimin për hir të besimit në Jezu Krishtin.
- ◆ Lutuni për të rinjtë e botës Arabe, që ata do të kenë mundësinë të mësojnë për besimet e tjera pa persekutime apo kërcënime.
- ◆ Lutuni për udhëheqësit politikë dhe fetarë në botën Arabe që të mbështesin lirinë për njerëzit e tyre që të zbulojnë dhe ndjekin vetë kuptimin rreth Perëndisë.

DHOMA QENDRORE E SHTËPISË SË ISLAMIT



DHOMA ARABE

Kombe	17
Grupe myslimane	240
Popullsia	236,992,225
Popullsia myslimane	204,473,439

Iraku: nga perandori në kaos

Zona rreth Irakut të sotëm ishte shumë e rëndësishme në kohën para Krishtit, nga ku lexojmë në Dhiatën e Vjetër për provincën Ninivea dhe Babilonia. Bagdadi ka qenë një qytet i njohur universitar dhe një qendër për artin dhe shkencën.

Por sot, pothuajse asgjë nuk ka mbetur nga këto. Dy vjet më parë, grupi ekstremist ISIS pushtoi territor të mëdha të Irakut, duke vrarë dhe skllavëruar ose dëbuar të Krishterët dhe grupet e tjera etnike si të Jezidis. Grupimi Shia dhe grupet Sunite myslimane janë duke luftuar njëri-tjetrin dhe armiqësia mes grupeve etnike vazhdon të përçajë kombin. Pakicat janë të përndjekura deri në cakun e rebelimit, ndërkohë shumë të tjerë jetojnë në mërgim. Të krishterët pothuajse e kanë braktisur vendin, në kërkim të sigurisë në Perëndim.

Por ka të tilla momente, në mes të gjithë kësaj kur duket se Perëndia është në veprim! Kur ata të krishterë të mbetur të tregojnë dashurinë e Krishtit tek myslimanët dhe Jezidis në mënyra praktike duke ofruar ushqim, batanije ose këshilla. Kur një ambient është i mbushur me njerëz që kërkojnë të

dinë më shumë për Krishtin. Kur Jezidis e hershëm venë në pikëpyetje shumë sekrete të besimit të tyre tradicional dhe duan të ndjekin Jezusin. Nga ky kaos, ne mund të shohim grimca shpërthyes të një Mbretërie të re.

LE TË LUTEMI

- ◆ Që ky popull dikur nomad të gjejnë rrugën për tek Jezusi.
- ◆ Për ata besimtarë që Perëndia i ka thirrur të tregojnë dashurinë e Tij tek populli i Mauritanisë.
- ◆ Që besimtarët e rinj Maurë do rriten e forcohen në besimin e tyre dhe në kurajon për të ndarë këtë besim



Turkistan: të udhëhequr nga Fryma

Anëmbanë hapësirës së Turkistanit më shumë se 200 miliona njerëz janë anëtarë të fiseve të lashta - të quajtura Uzbekët, Ujgurët, Kazakët, Tatarët, Turkmenët, Azerbajxhanasit, dhe Turqit. Gati 160 milionë nga kjo popullsi Turke janë myslimanë.

Ka lëvizje të shumta të muslimanëve Turq që sot kthehen në besimin në Jezus Krishtin. Shumë prej besimtarëve të persektuar të Turkistanit takohen në fshehtësi në shtëpi apo mjedise private. "Shpesh ne përballemi me probleme," tha një Uzbek i kthyer në besim, "por ende jemi duke lavdëruar Perëndinë." Ai vazhdoi: "Ne kemi një thënie, "Nëse ju kanë arrestuar, lavdëroni Perëndinë që nuk ju kanë rrahur. Nëse ju kanë rrahur, lavdroni Perëndinë që nuk ju kanë vrrarë. Dhe në qoftë se ju vrasin, lavdroni Perëndinë që tani ju jeni me Jezusin në qiell!"

Unë pashë këtë frymë mirënjohjeje edhe pas përballjes me vështrësiri, rreth 30 vjet më parë në mesin e disa pionierëve që takova në mësimdhënien e gjuhës angleze në një pjesë të ftohtë, të largët të Azisë Qendrore.

Atë mbrëmje, një nga mësuesit e quajtur

Gjon më prezantoi me një nga studentët e tij, Abdullanë, një besimtar me prejardhje besimi mysliman nga njerëzit Uigur.

Abdullah ishte i pari Uigur, i cili erdhi në besimin në Krishtin.

"Si e drejtëve Abdullanë drejt besimit?" pyeta Gjonin.

"Nuk e bëmë ne," u përgjigj Gjoni. "Fryma e Shenjtë dhe lutja e bëri." "Abdullahi erdhi tek unë vitin e kaluar me një ëndërr shqetësuese në të cilën dikush i dha atij një libër të shenjtë për ta lexuar." Çfarë mund të jetë ky libër? " më pyeti.

"Isha nervoz", tha Gjoni. "Në sirtarin tim në tavolinë kam pasur një përkthim të vjetër të Dhiatës së Re që është prodhuar nga misionarët Suedezë në një dorëshkrim të lashtë Uighur gati një shekull më parë".

"A mund të jetë ky libri i ëndrës tënde?"

e pyeta, ndërkohë që ia dhashë librin e vjetër Abdullait.

"Abdullahi hapi librin e vogël pak dhe tha: "Oh, ky është një dorëshkrim i vjetër. Babai im më mësoi se si ta lexoj këtë. "

"I lashë librin Abdullait. Disa javë më

vonë ai erdhi tek unë me lajmin se ai kishte pranuar Jezusin si Shpëtimtar dhe Zotin e tij.

"Kështu pra, siç e shihni," buzëqeshi Gjoni. "Lutjet e popullit të Perëndisë, dhe Fryma e Shenjtë drejtoi Abdullanë tek Jezusi."

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni për besimtarët me origjinë myslimane të përndjekur në Turkistan, për guximin dhe miqësinë si dhe inkurajimin në besimin e tyre.
- ◆ Lutuni për misionarët e guximshëm të cilët janë duke e çuar ungjillin tek secili prej 227 grupe myslimane të popullsisë së Turkistanit.
- ◆ Lutuni që kombet e Turkistanit do të promovojnë lirinë në lidhje me çështjet e fesë, në mënyrë që njerëzit që kërkojnë të vërtetën nuk do t'ju duhet të frikësohen prej arrestimit, goditjeve dhe vdekjes.

DHOMA TURKISTAN

Kombet	16
Grupe myslimane	227
Popullsia	203,251,345
Popullsia myslimane	159,225,454



Turqia: një udhëkryq për refugjatët

Ndodhet mes kryqëzimit të Evropës dhe Azisë, Turqia ka një histori të komplikuar me një rol të rëndësishëm në të dy kontinentet. Ajo ka qenë e implikuar në përballjen e krizës evropiane të refugjatëve, me refugjatët sirianë që largohen prej shkatërrimit të kombit të tyre e tani numërohen më shumë se 1,7 milionë.

Turqia ka filluar marrjen refugjatë nga Siria në fillim të luftës civile në më shumë se 5 vjet më parë, duke pritur se konflikti do të zgjidhet shpejt. Ndërkohë që lufta është zgjeruar në këtë situatë, ka krijuar tension në Turqi me refugjatët të ngelur në harresë – që s'kanë mundësi të kthehen në shtëpi, por nuk janë në gjendje të marrin lejë për punësim ose të vendosen përgjithmonë në Turqi. Turqit janë të shqetësuar gjithnjë e më shumë nga rritja e qirave të shkaktuar nga rritja e popullsisë dhe rrezikun e forcave të ISIS të sjellin konfliktin e tyre në Turqi. Grupi terrorist dyshohet të ketë shkaktuar vendosjen e bombës në Tëtorin e 2015-tës në Ankara ku u vranë 102 njerëz dhe u plagosën shumë të tjerë.

Pozicioni i Turqisë në krizën e refugjatëve

Sirianë i ka drejtuar ata në negociata me Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe BE-së në lidhje me rolin e tyre afatgjatë në mundësinë për vendosjen e refugjatëve në Evropë. Rezultati i këtyre bisedimeve

do të ketë një ndikim të madh për të dy palët Turqit dhe Sirianët. Të dy mbeten në udhëkryq, në pikpyetje se çfarë mban e ardhmja për ata që janë të lindur në vend dhe për ata që kanë qenë të detyruar të vendosen atje.

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni për tolerancë dhe durim nga ana e turqve të cilët janë duke ofruar strehim dhe mikpritje për refugjatët sirianë.
- ◆ Lutuni për paqe në Turqi, dhe për kishën në Turqi për të udhëhequr me shembull në unitet dhe dashuri.
- ◆ Lutuni për refugjatët në Turqi që kanë qenë atje për shumë vite, që kanë mall për vendlindjen. Edhe pse kjo mund të duket e pamundur, të lutemi për paqen në Siri.
- ◆ Sipas Psalmit 46: 9: "Ai bën që të pushojnë luftërat deri në skajet e tokës. Ai prish harqet dhe thyen shtizat; ai djeg mburojat me zjarr."



Hapësira persiane: Haik Hovsepian

Me rreth 100 milionë banorë, Bota Persiane përfshin të gjithë Iranin e sotëm dhe përhapet në vendet fqinjë të Irakut, Afganistanit dhe Taxhikistanit. Ndryshe nga myslimanët Suni në vendet e tjera të Shtëpisë të Islamit, shumica e myslimanëve në Iran janë Shitët.

Pavarësisht formimit të Republikës Islamike në vitin 1979, miliona Iranianë kanë kundërshtuar teokracinë islamike që ka shkaktuar një shkatërrim të tillë në kombin e tyre dhe qindra mijëra njerëz janë kthyer në besimin tek Krishti.

Mijëra prej tyre janë përballur me arrestim apo persekutimi dhe shumë prej tyre janë larguar nga vendi. Ata që kanë mbetur, adhurojnë fshehurazi dhe paguajnë me jetë dëshminë e tyre. Dëshmitarë të tillë si Iraniano-Armeni i krishterë, Haik Hovsepian.

Haik Hovsepian, u bë peshkopi i parë kombëtar i Asamblesë së Perëndisë të kishës në Iran në vitin 1980. Si një Armen etnik i krishterë, Haik u lejua të praktikonte besimin e tij, por të mos e ndante këtë besim me myslimanët. Haik refuzoi të mos ndante besimin e tij dhe kështu, ai drejtoi një

mysliman në besimin tek Jezusi. Ky person ishte Peshkopi Mehdi Dibaj.

Në vitin 1983, Dibaj u arrestua dhe u burgos pa gjyq dhe iu bë presion që të mohonte besimin e tij. Në vitin 1993,

në një gjykim të fshehtë, Dibaj u dënua me vdekje për shkak largimit nga besimi Islam.

Kur Bishop Haik mësoi për dënimin me ekzekutim, ai përballej me një zgjedhje. Si një armen, Haiku mund të qëndronte i heshtur dhe t'i shmangej persekutimit, ose ai mund të fliste. Haiku refuzoi që të braktiste vëllanë e tij me origjinë myslimane dhe doli publikisht me përpjekjen për t'a shpëtuar Dibajin. Përpjekjet e tij dhanë rezultat efektiv dhe si përgjigje e protestave ndërkombëtare, Dibaj u lirua më 16 janar, 1994.

Tre ditë më vonë, peshkopi

Haik u rrëmbye, u torturua dhe u gjet i vdekur në një varr pa mbishkrim.

Në funeralin e peshkopit Haik, Mehdi Dibaj foli me lotët e tij: "Kur Jezusi vdiq në kryq, vetëm Baraba e dinte se Jezusi kishte vdekur për të. Kur Bishop Haik vdiq, unë e di se ai ka vdekur për mua."

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni për dëshmitarë të guximshëm të krishterë si Haik Hovsepian për të vazhduar me shpalljen e ungjillit në popullsinë Persiane shite botërore myslimane.
- ◆ Lutuni për kombet në Persi që të lejojnë liri më të madhe në fe, duke lejuar njerëzit për të vendosur me vullnetin e tyre atë që ata do të besojnë.
- ◆ Lutuni për emigrantët irakianë dhe refugjatët që po rindërtojnë jetën e tyre në vende të reja, që ata të jenë të bekuar në vendet e tyre të reja dhe një bekim për ata përreth tyre.

HAPËSIRA PERSIANE

Kombe	3
Grupe popujsh myslimanë	105
Popullsia	99,009,985
Popullsia myslimane	97,957,533



Taxhikistan: në kërkim të Jezusit

Kombi i vogël Azisë Qendrore i Taxhikistanit është vendi i mbi 8 milionë njerëzve, 70% e të cilëve janë nën moshën 30 vjeç. A janë të rinjtë kryesisht myslimanë sunitë në këtë rajon të popullsisë së Taxhikistanit kurioz për Jezusin?

“Si mund t’a dimë vërtetë nëse ne jemi një nga delet e Jezusit?” e pyeti Aliun, një student i ri Tajik, ndërkohë që lexonim librin e Gjonit së bashku.

Ne ishim në mes të një studimi javor të Biblës me Aliun dhe 3 studentët e tjerë të rinj të universitetit të Azisë Qendrore. Ishte gjë e mirë për të parë interesin në rritje të Aliut për Jezusin ndërkohë që ne studionim së bashku. Ai kërkoi një Bibël, të cilën po lexonte



rregullisht, dhe madje e mori me vete kur ai u kthye përsëri në vendlindjen e tij për të parë familjen gjatë pushimeve verore.

6 javë më vonë, në fillim të vitit shkollor, ai u kthye në qendrën studentore, pa Biblën e tij.

Unë isha pak i shqetësuar dhe e pyeta se kush ia mori Biblën atij. A kishte pasur telashe? A iu mor Bibla atij?

Aliu ndau një histori që na habiti dhe na dha shpresë të madhe: motra e tij, në kërkim e saj për materiale

rreth Jezusit, ia kishte kërkuar Biblën atij për të mbajtur si pjesë e koleksionit të saj të leximit. Si kureshtarë e pyetëm më tej, e Aliu na tregoi se si ajo ishte gjithmonë në kërkim të më shumë informacioneve për tregime, filma, muzikë, ndonjë gjë - rreth Jezusit. Me përshkrimin e Aliut ajo ishte një “person në kërkim të Jezusit”. Ende një myslimane e mirë, por që kërkonte Jezusin.

Jezusi na tha se të korrat janë gati. Në një komb si



Si mund t’a dimë vërtetë nëse ne jemi një nga delet e Jezusit?



Taxhikistani, që jeton në male, të varfër, megjithëse i vështirë për t’u arritur shumë myslimanë - si Aliu dhe motra e tij - janë duke kërkuar për të vërtetën dhe shpresën. Dhe ata këtë e gjejnë në Jezusin.

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni që ky popull të jetë i hapur për Lajmin e Mirë që e gjejnë në Jezusin. Dhe që shumë njerëz, do të kenë mundësi të takojnë të krishterët të cilët me dashuri do të ndajnë Jezusin me ta.
- ◆ Aktualisht, ka shumë pak besimtarë në Taxhikistan. Lutuni që kisha do të shumëfishohet!
- ◆ Lutuni për një uri të madhe në mesin e Taxhikëve si në Taxhikistan dhe në Afganistan, Uzbekistan dhe Rusi. Ka shumë pak besimtarë në mes të Taxhikëve që jetojnë jashtë vendit. Lutuni që Perëndia do të dërgojë më shumë punëtorë në këto komunitete. (Luka 10: 2)



Miliona në lëvizje: një “hixhra” e besimit?

nga Steve Cochrane

Migrimi i miliona myslimanëve dhe të krishterëve veçanërisht nga Siria dhe Iraku përbëjnë një nga ngjarjet më të rëndësishme të pjesës së parë të shekullit të 21-të. Për shkak të luftës civile në Siri tani në vitin e saj të pestë, më shumë se katër milionë refugjatë kanë kërkuar siguri në vendet fqinje të rajonit, si dhe në Perëndim. Dy milionë kanë lënë Irakun me 1.9 milion të tjetër të zhvendosur brenda vendit. Kjo braktisje e qëllimshme e atdheut është e ngjashme me udhëtimet që kanë ndodhur në të tre besimet semite të Judaizmit, Krishtërit dhe Islamit.

Abrahami i cili u largua nga Ur-i i Mesopotamisë, i cili ishte atdheu i tij. Moisiu udhëhoqi bijtë e Izraelit për të dalë nga vendi i Egjiptit. Jezusi kur ishte foshnjë u mor nga prindërit e tij në Egjipt për t'u larguar nga Herodi. Këto janë disa nga lëvizjet e shumta në historinë e popullit Hebre dhe të krishterë.

Në Islam ka dhe një koncept të një udhëtimi të besimit të hasur në fjalën arabe “hixhra”. Fjalë për fjalë do të thotë “migrim” ose “rrugëtim”, ideja e “hijrës” është hasur mbrapa në kohën e rrugëtimin të Profetit Muhamed me besimtarë nga Meka për Medina, në 622-in. “Hijra” ishte për shkak të persekutimit nga tregtarët e vendosur në Mekë, dhe rezultoi në konsolidimin e bashkësisë së parë të myslimanëve. Kjo, shënoi gjithashtu vitin e fillimit për historinë islame, me datat e shkruara më pas. (Pas Hixhrit)

Një koncept i ngjashëm në Islam, është në fakt një nga pesë shtyllat, "haxhi". Që do të thotë "pelegrinim", e kjo i referohet udhëtimit të detyrueshëm të një myslimani (me disa përjashtime) gjatë jetës së tyre në qytetin e shenjtë të Mekës. Të dy konceptet e



Për shumë refugjatë që janë larguar nga atdheu, nuk ka asnjëherë premtim të kthimit përsëri.



"hixhrës" dhe "haxhi", edhe pse të ngjashëm, gjithashtu kanë dallime të ndjeshme. Të dyja bëhen me besim, të dyja përfshijnë largimin nga vendlindja me një synim të qëllimshëm. Por, në "hixhra" nënkuptohet një migrim më i gjatë, ndoshta një i tillë që do të zgjasë sa pjesa tjetër e mbetur e jetës në tokë.

Profeti dhe shokët u kthyen fitimtarë në Mekë në vitin 630 pas tetë vjetësh qëndrimi në Medinë. Për shumë refugjatë që janë larguar nga atdheu, nuk ka asnjëherë premtim të kthimit përsëri. A e shohin ata migrimin e tyre si një "hixhra" si qendër të besimit të tyre? Kjo është natyrisht e pasigurt. Por, të jetuarit në realitetin e një dimensionit shpirtëror mund të sjellë inkurajim për betejën e brendshme të tyre. Një pyetje tjetër për t'u konsideruar është

nga ana e komuniteteve, veçanërisht në Perëndim, pranimi i këtyre refugjatëve. A mos vallë kjo "hixhra" ka lidhje me dëshirën për të kthyer popullsinë evropiane dhe ato të tjera perëndimore në Islam përmes marrjes së vizave për të banuar atje? "Hixhri" i Profetit Muhamed me siguri përfshin lënien e Mekës për t'i shpëtuar persekutimit dhe forcimit të Islamin. Ai gjithashtu përfshin një dëshirë për t'i kthyer ata që ishin të përgjegjshëm në Medinë.

Por, megjithëse ka një shqetësim nëse refugjatët myslimanë do të kërkojnë të konvertojnë të tjerët, apo edhe të angazhohen në aktivitete terroriste si disa kanë paralajmëruar, duhet të ketë mikpritje të besimit bujar nga ana e atyre që pranojnë këta myslimanë (përfshi dhe të krishterët), nga Lindja e Mesme si dhe nga Afrikën Veriore. Edhe pse duke pasur motive të ndryshme, miliona nga këta emigrantë janë "hixhra" të vërtetë.

Shkrimtari Egjiptian mysliman Sahar El-Nadi ka përcaktuar një "hixhra të vërtetë" si dikush që jeton sipas pesë fushave të rëndësishme. Para së gjithash, ata që kanë një besim të fortë se edhe në vuajtje të mëdha vazhdojnë të besojnë dhe të varen nga Allahu. Së dyti, ka njohuri se ekziston qëllimi në këtë udhëtim dhe se nuk është i pakuptimtë. Së treti, "hixhra i vërtetë" vazhdon të përfshihet në zakonet , rregullat dhe aktet e adhurimit edhe në

atdheun e tij të ri. Së katërti, ka një dëshirë të vazhdueshme për Allahun që nuk është i zhytur nga presionet shoqërore rreth tyre.

Dhe së fundi, ka një përkushtim për një jetë të drejtë në mjedisin e ri.

Këto pesë shenjat e një "hixhra të vërtetë" janë sigurisht në përputhje e në vazhdimësi, si Judaizmi apo I besimit të Krishterë.

Ato gjithashtu

ofrojnë një kornizë për mikpritjen nga vendet tek të cilat keta "hixhra të vërtetë" kanë shkuar. Për të gjitha tre besimet koncepti i një "hixhri" ose udhëtimit, i cili do të zgjasë përgjatë jetës dhe në të vërtetë deri në përjetësi është një realitet i zakonit. Ideja e një "hixhri të vërtetë" siguron një urë në mes të besimeve që janë kaq të nevojshme në këtë kontekst të shekullit të 21-të.



Steve Cochrane ka qenë i përfshirë me lëvizjen "30 ditët" që prej fillimeve të saj. Ai është historian, misionar dhe futurist. Mund të lexoni blogun e tij në adresën stevecochrane823.com

Azia Jugperëndimore: një emër i ri!

Azia Jug-Perëndimore është një nga zonat më të mbushura me njerëz në Shtëpinë e Islamit. Është shtëpia e më shumë se 300 milionë myslimanëve nga 186 grupeve etnike, të cilët janë shpesh në konflikt me njëri-tjetrin dhe me forcat e jashtme. Në mes të gjithë kësaj, Perëndia është duke tërhequr mijëra myslimanëve drejt jetës së re në Jezus Krishtin!

Akbar al-Masih ishte një besimtar me origjinë myslimane nga Afganistani që kam takuar në Ravalpindi. Si një anëtar i grupit të njerëzve Pashtun, Akbar gjithë jetën e tij kishte ditur se populli i tij kishte luftuar Rusët, më pas fqinjët e fisit të Shiitë-ve vetëm për t'u bërë refugjatë në Pakistan, si pasojë e pushtimit amerikan në vitin 2012. Por, kur Akbar ishte në Pakistan takoi një familje të krishterë të cilët e dishepullizuan atë dhe e ndihmuan të rindëronte jetën e tij. E pyeta Akbarin për të më treguar se si ai kishte ardhur në besimin në Jezusin.

"Emri im në lindje," tha ai, "ishte Muhammad Akbar". "Kuptimi i emrit është Muhammedi është më i Madhi. Ai ishte gjithashtu emri i një heroi Pashtun i cili

kishte dëbuar Britanikët nga Afganistani në shekullin e 19. Shumë familje afgane l kishin quajtur bijtë e tyre Muhammad Akbar."

"Ndodhi që në mes të luftrave", tha Akbar, "unë isha në një vend të

hapur në kërkim të një pune. Një ditë erdha në një kinema që po shfaqte një film për jetën e Profetit Isa (Jezusit). Vendosa të hyja brenda."

"Unë e pashë filmin i vetëm, dhe mësova shumë gjëra në lidhje me Profetin Isa që unë nuk i dija më parë. U ndjeva zemërthyer kur pashë se si ata e rrahën dhe e gozhduan Atë në kryq.



AZIA JUGPERËNDIMORE	
Kombet	3
Grupe myslimane	186
Popullsia	713,922,175
Popullsia myslimane	315,998,874

Mendova me vete: "Tani profeti Isa do të marrë hak! Ai do të hedhë poshtë zjarret e qiellit për të shkatërruar këta njerëz të këqij!"

"Në vend të kësaj, Isai shikoi drejt tyre me dhembshuri. Isai tha: "O Atë, fali ata sepse nuk e dinë se çfarë po bëjnë."

"E pikërisht në atë çast", tha Akbar, "unë thashë në zemrën time: "Kjo është për mua."

"Në këtë moment unë vendosa të bëhesha një ndjekës i Isait. Unë e dija se kjo është ajo gjë që njerëzit e mi nuk e kishin. Ne gjithmonë kërkonim hakmarrje, sy për sy. Por, *Isa al-Masih* (Jezus Krishti) më tregoi një mënyrë të ndryshme."

Dhe kjo është arsyeja pse kam ndryshuar emrin tim," tha ai, "nga Muhamed Ekber në *Akbar al-Masih*, Mesia është më i Madhi!"

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni për kombet e Azisë Jug-Perëndimore të shkatërruara nga lufta. Lutuni që ata do të gjejnë një rrugë të re përpara përmes Princit të Paqes.
- ◆ Lutuni për dëshmitarë të guximshëm si Akbar al-Masih dhe misionarët që e dishepullizuan atë.
- ◆ Lutuni për 300 milion myslimanët e Azisë Jug-Perëndimore të cilët ende nuk e di paqen që tejkalon çdo njohurie që Jezusi iu ofron atyre.

Deobandi dhe qytetarët e tij

Qyteti i Deobandit në Indinë e Veriut ka një popullsi prej 100 000 banorësh. Është një popullsi e vogël krahasuar me shumë qytete të tjera përreth rajonit, dhe sërish Medreseja e Dar-UI-Uloom (një qendër islamike e të mësuarit) në Deoband është përfaqësuese për mijëra e miliona Myslimanë përreth botës. Deobandi (është një lëvizje e Myslimanëve Suni.)



Dar-UI-Uloom u hap në 1867 me qëllimin e mbrojtjes dhe promovimit të konservativëve Suni Islamik përreth kontinentit Indian.

Që nga ajo kohë me mijëra burra kanë studiuar aty, dhe kjo shkollë teologjike është përhapur edhe në vende si: Indi,

Pakistan, Bangladesh, Afganistan, Afrikën e Jugut, Britaninë e Madhe dhe në Amerikën e Veriut. 20% e Myslimanëve në Indi dhe në Pakistan e konsiderojnë veten e tyre të bëhen Deobandi (mbi 75 milion njerëz) dhe në Britani 40% e xhamive janë Deobandi.

Për shumë Myslimanë Suni, Deobandi përfaqëson një shkollë, një konservativitet dhe Islamit e pastër. Por sërish ka hamendësime për lidhje me militantët ekstremë. Talibanët kanë pasur disa fillesa në shkollën e Deobandit në Pakistan dhe hamendësime për ekstremistët u rrit aq shumë, sa që në 2013-ën, Dar-UI-Uloom nxori një deklaratë publike duke denoncuar terrorizmin.

Myslimanët vijnë nga e gjithë bota për të vizituar Deobandin. Disa vijnë si turistë vetëm për të parë ndërtesën e Dar-UI-Uloom, disa të tjerë qëndrojnë për 7 ose më shumë vite, për tu trajnuar në mënyrë të plotë drejtues xhamish apo drejtues shkollash teologjike. Një vizitor Iranian tha: "Ky është një vend ku Perëndia bën gjëra të mëdha!". Kështu qoftë Perëndi.

Imagjinoni si do të dukej nëse Deobandi

do të ishte i mbushur me frymën e qartësisë se kush është Jezusi, dhe se çfarë ka bërë Ai për ne. Ndikimi i Deobandit është shpërndarë kudo rreth kombeve dhe ata janë të pasionuar, për atë se çfarë besojnë dhe kanë qëllim ta ndajnë me të tjetër. Le të jetë ky përkushtim dhe pasion për lavdinë e Jezusit.

"Sepse dheu do të mbushet me diturinë e lavdisë të Zotit, ashtu si ujërat mbushin detin." Habakuku 2:14.

LE TË LUTEMI

- ◆ Për vetë qytetin e Deobandit që të jetë një qytet ku ka paqe dhe bekime. Të lutemi për myslimanët Hindu të cilët ndërhyjnë në rajon me forcë.
- ◆ Që e vërteta, drejtësia dhe paqja të rrjedhë nëpërmjet lidhjeve të Deobandit përreth botës.
- ◆ Për gratë në qytetin e Deobandit, shumica e të cilave jetojnë të fshehura, të njohin vlerën e tyre në Atin dhe të gjejnë dashurinë e Tij nëpërmjet Jezusit.

Azia juglindore

Pjesa më e populluar në “Shtëpinë Islamike” është Azia Jug-Lindore me përafërsisht 284 milion myslimanë të cilët jetojnë këtu. Në këtë vend ka me mijëra lëvizje, dhe secila prej tyre ka disa mijëra pagëzime ku besimtarë me prejardhje Myslimane, adhurojnë dhe e duan shumë Jezusin. Këto lëvizje, të cilat drejtojnë njerëz tek Krishti u kanë shkaktuar shumë persekutime, dëshmitarëve të emrit të Tij por edhe personave të cilët kanë përkthyer Biblën. Ata e kanë sjellë ungjillin në një mënyrë të kuptueshme, për Myslimanët që jetojnë në këto vende.

Kohët e fundit kam qenë duke mbikëqyrur disa prej këtyre lëvizjeve. Pyeta shumë persona të cilët ishin konvertuar në besimin e Krishterë në këtë rajon, “ çfarë përdori Zoti për të të sjell ty në besim tek Jezus Krishti?” Një nga shumë dëshmitë e paharrueshme vjen nga një besimtar më emrin Sharif.

“Si një djalë i ri, unë u përjashtova nga Shkolla Myslimane sepse, u bëja mësuësve pyetje të vështira. Një herë mësuesja më ulëriti, “Ti je një mëkatar, ti do të shkosh në ferr!”. Babai im ishte shumë i inatosur. Ai më

nxori jashtë nga shtëpia, dhe ndaloj çdo anëtar të familjes të komunikonte më mua.

“Një ditë , unë u surprizova shumë kur një misionar i thinjur erdhi dhe më foli:

-“Përsëndetje djalosh! –A dëshiron të bëjmë një xhiro së bashku me këtë karrocën? Përpara se ai të largohej, më dha librin e Biblës, Dhiatën e Re.

“Qëndrova gjithë natën zgjuar, dhe për një moment po lexoja tek Gjoni 3:17 ku thuhej, “ Sepse Perëndia nuk e dërgoi Birin e vet në botë që ta dënojë botën, por që bota të shpëtohej prej tij.”

Vite më vonë, ndërsa Sharif po më ritregonte historinë, lotë rrodhën nga sytë e tij, “E sheh, unë nuk isha i dënuar për në ferr, nuk isha thjesht një mëkatar. Jezusi kishte ardhur në botë për të më shpëtuar mua.”

Vite më vonë, Sharif u përball me shumë vështirësi për shkak të besimit të tij në Jezus Krishtin. Babai i tij e kërcënoi se do ta vriste; një grup të rinjsh Myslimanë e rrahën atë disa herë, dhe shumë herë ishte shumë pranë vdekjes.

“Nuk ka rëndësi, - tha Sharif. “Nëse ata do ta presin trupin tim në copa, çdo copë do të thërrasë se Jezus Krishti është Zot!”

Vite më vonë Sharif e drejtoi babain e tij tek Krishti. Ai më tha se tashmë ata bëjnë takime në shtëpinë e tij. Sot, Sharif është pjesë e një lëvizje të cilët drejtojnë Myslimanë tek Jezus Krishti, me më shumë se 100,000 besimtarë.

LE TË LUTEMI

- ◆ Le të lutemi për lëvizjen “Myslimanët për Krishtin” në Azinë Jug-Lindore që të shumëfishohet.
- ◆ Le të lutemi për besimtarë të guximshëm si Sharif, në mënyrë që ata t’i bëjnë ballë persekutimit, e të qëndrojnë besnik ndaj Krishtit.
- ◆ Le të lutemi për 284 milion Myslimanët e humbur në Azinë Jug-Lindore që të vinë në besim tek Jezus Krishti.



AZIA JUGLINDORE	
Kombet	4
Grupe myslimane	65
Popullsia	844,398,260
Popullsia myslimane	283,393,591

Bihari

Baisi është një qytet me rreth 10 000 persona në Bihar të Indisë. Zyrtarisht është i njohur për qëndresën e fortë ndaj Islamit, dhe për djem të rinj të cilët vijnë në Baisi për tu trajnuar në rrugët e Islamit. Por sërish, në një farë mënyre apo në një tjetër, kur ne u njohëm me Abdulin dhe babain e tij të cilët punonin në një dyqan anës rrugës, ata kishin një interes shumë të madh për Jezusin, dhe librat e tij.

Në muajt e fundit ata kanë qenë duke studiuar librat e Jezusit, duke iu bindur atyre që thuhet në libër, madje edhe duke drejtuar studime të ngjashme me miqtë dhe të afërmit e tyre. Disa nga drejtuesit Myslimanë në qytet kanë filluar të tregojnë interes për t' i lexuar këto libra, dhe për të dëgjuar më shumë rreth Jezusit. Diçka po ndodh në Baisi!

Shteti i Biharit në Indi, përmban rreth 100 milion njerëz, të cilët jetojnë si në Baisi. Vetëm disa dekada më parë qytetit të Biharit i referoheshin si “Varreza e Misionit” sepse asnjë shërbesë nuk ishte me rrënjë të forta dhe të rritej. Gjërat po fillojnë të ndryshojnë, por Bihari sërish ka një popullsi të Krishterë prej 05%- e ngjashme me Somalinë dhe Afganistanin, me përqindjen më të ulët në botë.

Gjërat kanë filluar të ndryshojnë në Bihar, por është bërë shumë pak për të fituar 17-20 milion Myslimanët e këtij shteti. Myslimanët këtu po presin të dëgjojnë Lajmin e Mirë për

Jezusin. Në të ardhmen, kur dikush në këto fshatra do të pyes ku janë të Krishterët ose kishat, çfarë do t' u themi?

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni që Perëndia i së korrës të ngre punëtorë në Baisi dhe në të gjithë Biharin po ashtu.
- ◆ Lutuni që Fryma e Zotit dhe Fjala e Perëndisë të afrojnë drejtuesit Myslimanë dhe të gjitha grupet familjare tek Jezusi në të gjithë vendin e Biharit.
- ◆ Lutuni që Shkrimi tek Isaia 55:11 do të kalojë në Bihar: “...Ajo nuk do të mëkthehet bosh mua, pa kryer atë që dëshiroj dhe pa realizuar atë për të cilën e dërgova.”



Dhoma e Indo-Malajzisë

Dhoma e Indo-Malajzisë në “Shtëpinë e Islamit” përfshin Malajzinë, Singaporin, ishujt e Filipineve Perëndimore dhe në Indonezi më shumë se 17,000 ishuj. Indonezia është vendi më i madh Mysliman në botë me një popullsi prej 250 milion, nga ku 87% janë Mysliman.

INDO-MALAYSIA

Kombet	5
Grupe mysliane	282
Popullsia	283,696,115
Popullsia mysliane	201,000,020



Në 1870, lëvizja e parë e përparuar e Myslimanëve të Krishtin ndodhi në Indonezi. Më pas në 1967-1971 Indonezia përjetoi kthimin më të madh të mundshëm të myslimanëve në të krishterë. Më shumë se dy milion myslimanë u pagëzuan në kishat e Krishtera.

Sot, shumë Myslimanë në Indo-Malajzi po ndjekin një kurs “Pesë hapat drejt Jezusit” që një burrë me emrin Mike Shipman e mori si zbulësë nga Jezusi, e cila flet rreth gruas Samaritane tek Gjoni 4. Mike i quan këto 5 hapa të ndarjes së besimit të Krishterë “Kushdo, Kudo, Në çdo kohë”.

- **HAPI I PARË** i kursit, është lidhja me një Mysliman. Shumë Mysliman në Indo-Malajzi asnjëherë nuk e dëgjojnë ungjillin sepse ata nuk njohin asnjë të Krishterë.
- **HAPI I DYTË** është hapja e bisedës për Perëndinë. Në këtë rajon, myslimanët duan shumë të flasin për Perëndinë. Në këtë pjesë Mike sugjeron që myslimanëve t’u bëhet pyetja “çfarë bën ti në besimin tënd për të kënaqur Perëndinë?”, pyetje, e cila është shumë mirë, për të hapur një bisedë, e më pas për të folur për gjëra shpirtërore.
- **HAPI I TRETË** përfshin eksplorimin e rezultateve të përpjekjeve tona për të kënaqur Perëndinë, dhe zakonisht kjo sjell pyetje për sigurinë e shpëtimit. Shumë myslimanë pranojnë që ne nuk mund ta

njohim vullnetin e Perëndisë, apo të kemi besim që Ai do të na shpëtojë ne.

- **HAPI I KATËRT** flet për historinë e Jezusit, vdekjen e tij për jetën e përjetshme.
- **HAPI I PESTË** ftoni miqtë tuaj të pranojnë shpëtimin nëpërmjet Jezusit.

Ndarja e mesazhit të Jezusit është e lehtë për besimtarët e rinj dhe për ta ndjekur atë, dhe si pasojë e kësaj mesazhi është ndarë në të gjithë Indo-Malajzinë dhe me mijëra myslimanë kanë ftuar Jezusin të jetë Shpëtimtari i tyre, dhe tashmë ata po ndjekin Krishtin.

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni që metodat për të ndarë ungjillin të kenë ndikim tek njerëzit, siç janë; televizioni satelitor, Filmi i Jezusit, Tre pyetjet. Lutuni që Ungjilli të ndahet në të gjithë Indo-Malajzinë.
- ◆ Lutuni për persekutimet që gjithmonë shoqëron lëvizjet e krishtera ndërsa ungjilli ndahet në Indo-Malajzi.
- ◆ Lutuni për 280 milion Indo-Malazezët myslimanë të humbur, në 282 grupe të ndryshme, shumicës prej të cilëve askush nuk u ka dëshmuar për Krishtin.

Një udhëtim Indonezian: *Marantau*

Prifti iu përgjigj: “Shkoni në paqe; rruga që bëhet kryhet nën shikimin e Zotit.”

Gjyqtarët 18:6

Në mesin e shtresës rurale të njerëzve të cilët jetojnë në ishullin e Sumatrës në Indonezi, ideja e “*marantau*” është shumë e përhapur. *Murantau* me fjalë më të tjera, është “të endesh pa një qëllim të caktuar”.

Koncepti Indonezian i *marantau*, zakonisht përfshin një individ në moshë të re, i cili largohet nga shtëpia për një periudhë të pacaktuar kohore, për të kërkuar famë ose pasuri, apo edhe për të fituar eksperiencë nga puna dhe jeta.

Zakonisht ky i ri është i paqartë për atë se çfarë po kërkon. Ai nuk ka shumë presion social nga familja, shoqëria apo të afërmit gjatë kohës që është në *marantau* e tij. Në këto raste është më e lehtë, dhe më pak e rrezikshme për të ndarë ungjillin me këta të rinj, jashtë fshatrave të tyre, pasi ata vijnë nga vende besnike të besimit Islamik.

Po ashtu edhe e kundërta është e vërtetë. Të dërgosh të rinj Indonezian si misionarë është e lehtë! Ata justifikohen tek të afërmit e tyre duke thënë se janë në udhëtimin e tyre të *marantau*. Kjo është një mënyrë e pranueshme për të filluar njohjen e komunitetit dhe ndarjen e mesazhit të Jezusit.

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni për Indonezianët në udhëtimin e tyre – për të gjithë ata që nuk e kanë një qëllim, të gjejnë qëllimin e vërtetë... Mbretërinë e Perëndisë.
- ◆ Lutuni që të Krishterët, veçanërisht biznesmenët, të shohin këta të rinj si njerëz me potencial në mënyrë që të investojnë në ta, për biznes dhe për Mbretërinë e Perëndisë.
- ◆ Lutuni për dërgimin e misionarëve të rinj entuziastë, për udhëtimin e tyre në “*marantau*” që të arrijnë zonat e paarritura për Perëndinë. Lutuni që Mbretëria e Perëndisë të vendoset në vende ku Ungjilli nuk është përhapur akoma.



Cham-i Perëndimor i Kamboxhias

Kandi ishte e shqetësuar. Të jetoje në zonat rurale të Kamboxhias me probleme serioze shëndetësore, ishte shumë e vështirë për të gjetur shërbim shëndetësor në vitet 2000. Bashkëshorti i saj e la atë së bashku me fëmijë, por në këtë periudhë të jetës së saj, Kadi takoi një çift që Perëndia e solli në jetën e saj.

Ky çift që Kadi takoi, kishin mësuar gjuhën e saj dhe e dëgjonin atë me shumë kujdes. Ata u lutën së bashku me të dhe e dërguan në qendrën "Mercy Medical Centre" -Qendra Mjekësore Shpresë", ku aty takoi më shumë njerëz të Perëndisë të cilët ofronin shërbime mjekësore me çmim të ulët për të varfrit. Këtu, Kadi dëgjoji më shumë për Jezusin dhe për sakrificën të dhënë për të gjithë njerëzit.

Popullsia në qytetin e Kandit quhet "cham". Ata mund të gjenden në çdo provincë afër Kamboxhias, zakonisht afër lumenjve të mëdhenj. Njerëzit "chame" kanë origjinën nga mbretëria Champa e cila si vendndodhje, ka Vietnamin e sotëm. Për shkak të konfliktit me Vietnamezët kohë më parë, njerëzit Cham migruan në numër të madh në Kamboxhian Perëndimore dhe

u quajtën Cham-ët Perëndimorë, me një popullsi prej 400, 000 banorësh. Shumë pak nga populli Cham, kanë dëgjuar ose kuptuar se kush është Jezusi.

Në vitin 2000, Zoti shtyu një prej shërbëtorëve të tij për të filluar për t'u lutur çdo javë për njerëzit Cham, për të ardhur në besim tek Jezusi. Në 2014 ishin dhjetë ose më shumë besimtarë nga vende të ndryshme, të cilët u bashkuan për t'u lutur për njerëzit Cham. Edhe në ditët e sotme kjo gjë vazhdon, dhe është çelësi për t'i sjellë ata tek Jezusi. Sot, nëpërmjet këtij udhëtimiti, ne do t'i shtojmë me qindra e mijëra njerëz, të cilët luten për këtë popullsi.

Pas shumë vitesh, kur çifti që përmendëm më sipër takuan Kadin sërish, Zoti iu përgjigj lutjeve të tyre duke e shëruar atë. Ajo u bë një besimtare e zellshme e Jezusit. Bashkëshorti i saj u rikthye dhe djali i saj u bë një ndjekës i Jezusit gjithashtu. Së bashku, ata filluan

një Studim Bible në fshatin e saj, duke iu përgjigjur pyetjeve që njerëzit kishin për Jezusin. Cham-ët janë në një udhëtim drejt besimit!

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni për Kadin dhe djalin e saj që të rriten në besim, dhe që bashkëshorti i saj të bëhet besimtar.
- ◆ Lutuni për vazhdimësinë e përkthimit të Shkrimit në gjuhën e tyre.
- ◆ Lutuni për një lëvizje të njerëzve Cham në besim drejt Jezusit.



Rrugëtimi i besimit

Rrugëtimi që merr një mysliman për t'u bërë i krishterë nuk është i lehtë. Por studiuesit të cilët flasin me të krishterë të cilët vijnë nga familje myslimane, tregojnë se ka shenja të cilët ndihmojnë myslimanët në të gjithë botën për të drejtuar tek Krishti.

Një shenjë është Kur'ani. Shumë myslimanë e kanë të vështirë të kuptojnë Kuranin sepse është i shkruar në Arabisht. Kur myslimanët lexojnë Kur'anin në gjuhën e tyre, shumica prej tyre pranojnë se ai nuk u përgjigjet disa prej pyetjeve të tyre, si siguri për besimin. Një burrë nga Azia e Jugut, i cili ka drejtuar shumë persona në besim, tregon se leximi i Kur'an-it në gjuhën e tij, ishte fillesa e kërkimit të tij për shpëtimin dhe përfundoi duke ia dorëzuar jetën e tij Jezusit.

Një shenjë tjetër vjen nga historitë për profetin Muhamed. Myslimanët e respektojnë profetin Muhamed, por ata të cilët e lexojnë me kujdes Kur'anin dhe Hadithin (histori të marra nga jeta e Muhamedit), shqetësohen dhe gjejnë kontradikta që i inkurajojnë ata të gjejnë një rrugë tjetër se ku të besojnë.

Një shenjë përfundimtare që shumë besimtarë me prejardhje myslimane gjejnë është dhuna që ka shoqëruar Islamin për 14 shekuj. Ideja që Myslimanizmi është një fe e paqes, është e mohuar nga Myslimanët të cilët jetojnë me realitetin e luftës dhe të dhunës çdo ditë. Kur shohim shpërthimet e myslimanëve në dhunë, shohim se këto raste raportohen më shumë nga myslimanët vetë, dhe shumë nga këto myslimanë, po e refuzojnë këtë dhunë sot për të ndjekur Princin e Paqes.

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni për myslimanët të cilët janë në pikëpyetje për besimin e tyre; lutuni që gjatë kësaj kohe ata të takojnë me persona të cilët kanë kaluar të njëjtën situatë dhe që ata t'i drejtojnë ata tek Krishti.
- ◆ Lutuni për studentët dhe mësuesit që të studiojnë Islamin dhe një zemër të sinqertë dhe kërkuese dhe me kurajo për të bërë pyetje.
- ◆ Lutuni për ata myslimanë të cilët kanë vendosur të ndjekin Krishtin, që ata të gjejnë shoqëri me të njëjtat interesa dhe të gjejnë paqe në besimin e tyre të ri.



Rrugëtimi im: Në kërkim të pranisë së Perëndisë

Një dëshmi nga një besimtar me prejardhje Myslimane:

Unë kam lindur në një familje myslimane. Disa nga pjesëtarët e familjes time nuk ishin fetar, disa ishin të shqetësuar për anën humane, dhe disa ishin fetarë. Babai im Sufi ishte shumë fetar, dhe kishte një ndikim shumë të fortë në jetën time. Në moshën dhjetë vjeçare, fillova të kërkoja për Perëndinë. Kërkoja me ngulm prezencën e Tij, dhe bëja çdo gjë që munda me forcën time për të shkuar më pranë Tij.

Si një i ri, vazhdova të kërkoja me më shumë intensitet, duke u lutur, agjëruar dhe duke shkuar në xhami. Unë jo vetëm që po lutesha rregullisht, por po kërkoja

“

Eja shikoje vetë.
Jezusi është i gjallë, Ai shëron
dhe i bën njerëzit të lirë.

”

për Perëndinë me gjithë zemrën. Ato vite kërkimi të Perëndisë në Islam, përfunduan në kuptimin se Perëndia nuk ishte afër meje, në

fakt ai dukej sikur ishte me distanca larg nga unë. Në kohën që fillova kolegjin u dorëzova së kërkuari Perëndinë.

Një mbrëmje, ndërsa po ecja së bashku me shokët e mi, dëgjova Ungjillin për herë të parë. Një i Krishterë i rilindur të cilin e kisha takuar nga një shok i përbashkët, po më ndante dhe dëshmonte Ungjillin e Jezusit në rrugët e Kairos. Një javë më vonë, shkova në kishë bashkë



me të, dhe vetëm pas katër javësh, pranova Jezusin si Shpëtimtarin tim! Eksperienca ime ishte e njëjta me atë të djalit tjetër, nga mënyra si ai ma shpjegoi: “Eja shikoje vetë. Jezusi është i gjallë, Ai shëron dhe i bën njerëzit të lirë.”

Atë mbrëmje unë iu luta Jezusit për herë të parë. Pyetja ime ishte: “Cila është rruga? A është Krishti Zot? Përgjigja ishte “Po”. E më pas thashë në zemrën time: “OK” dhe menjëherë përjetova prezencën e Perëndisë, gëzim prej qielli dhe paqe. Unë u bëra i krishterë kur i thashë PO Jezusit!

Pak kohë më vonë, kalova një persekutim të fortë nga familja ime dhe komuniteti vendas, por prezenca dhe lavdia e Perëndisë ishte kaq e fortë në mua, sa që nuk doja t’ia dija për humbjet dhe rrezikun që mora duke u bërë ndjekës i Jezusit.

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni që myslimanët të kërkojnë Perëndinë dhe jo fenë.
- ◆ Lutuni për myslimanët të cilët ndjekin Krishtin në vende të ndryshme të cilët nuk kanë lirinë e besimit, të gjejnë mënyra për të qenë një dëshmi e qartë tek të afërmit dhe miqtë e tyre.
- ◆ Lutuni për myslimanët që po kërkojnë prezencën e Perëndisë, që ata ta gjejnë Atë në çdo mënyrë të mundshme.

Luton: qëndresa kundër ekstremizmit

Dyzet milje në Veri të Londrës, në Angli shtrihet qyteti i Lutonit. Mbi 25% e popullsisë së Lutonit 215, 000 janë myslimanë. Që nga viti 1990 qyteti i Lutonit është njohur në mënyrë të padrejtë, si një vend ekstremist mysliman, por kohët e fundit njihet gjithashtu si një vend i ekstremizmit anti-mysliman.

Në Maj të vitit 2009, në një Ushtri Britanike u bë një protestë. Qyteti u mbush me demonstrata dhe kërcënime nga një grup i vogël Myslimanësh ekstremistë, dhe një xhami u hodh në erë nga bombat. Një grup i quajtur "Protestuesit e Bashkuar Anglez (EDL) (English Defence League), ishin mbledhur për të demonstruar kundër myslimanëve, dhe shumë shpejt u përhapën në të gjithë vendin.

Në një kishë lokale ishte një anëtar me emrin Peter Adams, dhe kishte dhunti paqe bërjen. Ai dëshmoi kaosin dhe urrejtjen e madhe që njerëzit kishin për myslimanët. Ai foli me drejtuesit e kishës dhe me miqtë e tij Myslimanë të cilët, si shumica e komuniteteve myslimane, në mënyrë të menjëhershme kundërshtuan dhe dënuan të gjithë ekstremistët myslimanë. Dy muaj

më vonë, duke qëndruar përkrah Imanit të xhamisë së bombarduar, me drejtues të tjerë myslimanë dhe të krishterë në një konferencë për shtyp ata bënë një deklaratë:

"...këto grupe nuk përfaqësojnë shumicën e komunitetit tonë. Si Myslimanë dhe të Krishterë në Luton ne jemi të përkushtuar të rrisim kuptueshmërinë me njëri-tjetrin dhe të punojmë së bashku për mirë. Duke e bërë këtë ne frymëzohemi nga fjalët që lindin në zemrat tona nga Shkrimet e Shenjta të secilit, ku ne jemi të përkushtuar ta duam Perëndinë dhe fqinjët tanë. Si fqinj në këtë qytet ne do të punojmë të zbulojmë këto gjëra që na bashkojnë dhe të festojmë në to. Aty ku ne jemi të ndryshëm, ne jemi të përkushtuar të gjejmë kuptueshmëri dhe besim, në vend që të restaurojmë konfliktin dhe urrejtjen. Le të respektojmë njëri-tjetrin, të jemi të drejtë, të sjellshëm dhe të jetojmë në paqe, harmoni dhe në mirësi të përbashkët..."

Kjo deklaratë ka përparuar shumë. Ndërsa EDL ka qenë një forcë për ndarje, miqësia ndërmjet besimit dhe drejtuesve të komuniteteve po rritet dhe ka lejuar që situatat e vështira të zgjidhen.

Peter thotë: "Në këtë kohë ku shumë janë të bindur se myslimanët dhe të krishterët do të kenë përplasje, unë jam i bindur se kjo gjë nuk



Miqtë e mi myslimanë e dinë se unë jam i apasionuar pas besimit tim, dhe më respektojnë për këtë gjë.



do të ndodh. Fatkeqësisht, zërat e Krishterë cilësohen si ata të cilët mbështesin konfliktin. Ne duhet të gjejmë një mënyrë tjetër! Miqtë e mi myslimanë e dinë se unë jam i apasionuar pas besimit tim, dhe më respektojnë për këtë gjë. Ata e dinë se unë do doja shumë t'i shihja ata të fituar për Krishtin.

Por emri i Krishti nuk do të lartësohet siç duhet, nëse të Krishterët janë të njohur për frikën dhe urrejtjen.

LE TË LUTEMI

- ◆ 1 Gjoni 4:18 thotë: "Dashuria perfekte nuk ka frikë." Lutuni për pendesë dhe frikë nga Zoti, dhe kërkojini atij t'ju mbush ju dhe komunitetin tuaj me dashuri për Myslimanët.
- ◆ Lutuni për mundësi të cilat sfidojnë stereotipat negative që janë për Myslimanët kudo.
- ◆ Lutuni për mundësi për të treguar dashuri për Myslimanët si miq dhe shtetas të vendit tuaj.

Emigrantët e SHBA: një portë globale

Në një studim që është bërë nga një Bankë Botërore, tregon se më shumë se 250 milion e popullsisë sot janë emigrantë. Destinacioni më i njohur për emigrantët janë Shtetet e Bashkuara. Në mesin e këtyre miliona njerëzve që vijnë në Amerikë, janë disa nga lista e vendeve të arritura për Krishtin. Perëndia po bën diçka të re! Ai ka sjell njerëz nga fundi i botës, në një derë të re, në një

nga vendet e Krishtera të botës. Si do të përgjigjen ata?

Në vitin 2001, një misionar i ri me emrin Kris shkoi në Mali, në Afrikën Lindore ku

aty ai punoi në një fshat të largët në mes të 160, 000 njerëzve folës të gjuhës Bambaba me njerëz të quajtur Uasolau. Myslimanët Uasolaut nuk kishin dijeni për të krishterët apo kishat. Ndërsa ai mësoi gjuhën e tyre, Kris zbuloi Uasolaut ishish shumë të hapur ndaj tij.

Fatkeqësisht, Kris u sëmur shumë rëndë dukë jetuar në fshatin Uasolau, dhe në

këtë mënyrë ai nuk mund të kthehej dot. Ai nuk u dorëzua. Në një vizitë në qytetin e New York në vitin 2006, Kris dhe bashkëshortja e tij zbuluan një komunitet nga Uasolau dhe aty takuan një djalë me emrin Jamal, besimtari i parë i krishterë nga fshati që Kris kishte takuar ndonjëherë. Jamal i tha Krisit: “Unë u bëra një ndjekës i Jezusit në Mali 22 vite më parë si rezultat i ëndrrave për Isa al-Masih (Jezus Krishtit). Kur i tregova familjes time,

ata më kërcënuan me vdekje dhe në këtë mënyrë u arratisa për në New York.”

Më pas Jamali i tha Kris: “Për 22 vite kam qenë duke iu lutur Perëndisë të më dërgoj një vëlla për të më ndihmuar mua të arrijmë njerëzit e mi.” Më pas Jamali vështrroi në sytë e Krisit dhe tha: “Ti je përgjigja e lutjeve të mia.”

Disa muaj më pas Kris dhe familja e tij u zhvendosën në New York. Sot, atje janë më shumë se 100 banorë ndjekës të Isa al-Masih. Nëpërmjet lidhjeve të Jamalit, dyer u hapën për Ungjillin në fshatin e tij dhe fshatra të tjerë të Uasolaut në Mali, të cilat kontribuan në kishat e para në Afrikën Lindore.

Zbuloni më shumë për misionarët të cilët punojnë për të dishepulluar skajet e botës në qytetet e tjera të cilat janë si porta hyrëse. (www.GlobalGates.info)

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni për emigrantët e pa arritur, të cilët po lënë vendet e tyre duke kërkuar një jetë të re. Lutuni që ata të gjejnë një jetë të re në Krishtin.
- ◆ Lutuni që te krishterët amerikanë të arrijnë qindra të tjerë.
- ◆ Lutuni për kishat që shërbejnë (siç është Global Gates) që t'i tejkalojnë barrierat kulturore që ekzistojnë.



Rohingya: një popull mes dy botëve

Populli i Rohingisë jeton në kufirin mes hapësirës së Azisë Jugore dhe asaj Indo-Malajziane në Shtëpinë e Islamit. Kjo vendndodhje mes ndryshimesh të stërmëdha etnike, gjuhësore, fetare dhe politike u shkakton atyre shumë sfida.

Rohingët myslimanë kanë jetuar në pjesën veriore të asaj që tani quhet Mianmar, prej

shekujsh tashmë. Në pjesën më të madhe të asaj kohe, ata jetuan në paqe me fqinjët e tyre në shumicë budiste. Kur Mianmari (i njohur në atë kohë si Burma) fitoi pavarësinë më 1948, Rohingët u njohën fillimisht si minoritet më të drejta të barabarta. Por, më 1982,

diktatura ushtarake në fuqi nxori një ligj, i cili bëri që Rohingët të mos pranoheshin më si shtetas. Kjo gjë la dy milion njerëz si një nga grupet më të mëdha etnike në botë pa kombësi të njohur.

Diskriminimi u përkeqësua më 2012, kur plasi dhuna mes Budistëve dhe Rohingëve. Qindra njerëz u vranë dhe shumë fshatra

rohingë u shkatërruan. Që në atë kohë, 100 000 rohingë janë mbajtur në kampe refugjatësh ose geto, shpesh pak kilometra larg shtëpive të tyre të para. Kjo situatë ka çuar drejt një lëvizjeje në rritje të refugjatëve. Qindra mijëra rohingë janë arratisur në vendet fqinje dhe përtej tyre. Fatkeqësisht, ata bien viktimë e trafikimit njerëzor ose përfundojnë në veprimtari kriminale.

Rohingët janë në një udhëtim drejt një të ardhmeje të pasigurtë – pa atdhe, pa përkrahje, të çrënjosur dhe pa shpresë. Por Perëndia “nuk harron britmën e të pikëlluarve” (Psalmi 9:12).

Në disa vende, rohingët kanë gjetur shpresë dhe gëzim duke besuar në Jezus Krishtin. Por shumica e këtyre njerëzve të çmuar nuk kanë ende një mundësi për të dëgjuar për Ungjillin.

LE TË LUTEMI

- ◆ Për drejtësi në zgjidhjen e konfliktit.
- ◆ Që rohingët të jetojnë në paqe në atdheun e tyre dhe në zonat ku ata largohen.
- ◆ Për përpjekjet globale që po bëhen për t'u dhënë rohingëve një mundësi të zhvillohen, të jetojnë me dinjitet dhe t'u ofrojnë fëmijëve të tyre një të ardhme më të mirë.



Sirianët në një udhëtim të pasigurt

Deri para pak kohësh, Siria ishte një shtet i qëndrueshëm dhe në zhvillim. Fëmijët shkonin në shkollë dhe të rinjtë në arsimin e lartë. Nën pushtetin e Asadit, minoritetet fetare dhe etnike jetonin në paqe me shumicën myslimane sunite.

Me ardhjen e Pranverës Arabe, situata ndryshoi në mënyrë dramatike. Më 2011, shpërtheu një luftë civile, e cila përkeqësohet vit pas viti. Më shumë se gjysma e popullsisë i kanë braktisur shtëpitë e tyre dhe kanë nisur një udhëtim të pasigurt. Shumë prej tyre kanë lëvizur brenda vendit të të afërmit dhe miqtë e tyre. Më shumë se 4 milion njerëz jetojnë sot në vendet fqinje, të cilat kanë vështirësi t'i strehojnë ata.

Askush nuk e di çfarë do të sjellë e ardhmja.

Por veç kësaj, ky udhëtim i pasigurt ka bërë të mundur gjithashtu që myslimanët t'i arratisin një mjedisi shoqëror shumë të kontrolluar. Kjo u

ka dhënë atyre liri të tregojnë haptas interes ndaj besimit të krishterë. Përveç kësaj, gjërat e tmerrshme të kryera nga ekstremistët e të ashtuquajturit Shtet Islamik sfidojnë shumë myslimanët të vënë në diskutim vlerat e besimit të tyre. Shumë myslimanë janë sot më të hapur ndaj ftesave të kishave, që u ofrojnë atyre dashuri të prekshme përmes shpërndarjes së pakove

ushqimore, batanijeve, materialeve ngrohëse dhe këshillimit. Në disa zona, kishat janë plot me besimtarë të rinj, në zona të tjera ka zemra të hapura dhe shumë mundësi për të folur në lidhje me besimin.

Një familje në Bejrut tregon se si ata ikën nga Siria në Liban,

duke lënë gjithçka mbrapa. Ata jetojnë në një apartament të vogël. Është e vështirë të ushqesh të gjithë familjen dhe fëmijët e tyre nuk mund të shkojnë në shkollë çdo ditë. Por në mes të këtyre situatave, ata thonë: "Kemi humbur shtëpinë tonë, por në Jezusin kemi gjetur diçka shumë më të cmuar."



Shumë myslimanë janë sot më të hapur ndaj ftesave të kishave.



LE TË LUTEMI

- ◆ Që lufta në Siri të marrë fund. Nga ana njerëzore kjo duket e pamundur, por Zoti është në gjendje.
- ◆ Që kisha do të përgjigjet me gjithë zemër për miliona refugjatë dhe nevojat e tyre fizike dhe psikologjike.
- ◆ Për të ndihmuar dhe mbështetur refugjatët në nevojat e tyre urgjente dhe ato në vazhdim, ndërsa integrohen në kombet e tyre të reja.

Kampi Jida: refugjatët si lajmëtarë të Krishtit

Në Bibël, gjejmë histori të njerëzve që janë dëbuar nga atdheu i tyre dhe ende sot refugjatët po kërkojnë siguri dhe strehim. Qindra mijëra refugjatë kanë gjetur një shtëpi më të sigurt në Sudanin Jugor, shteti më i ri në botë.

Dagig, Ashron, Lira, Moro, Shad dhe Tabania janë vetëm disa prej myslimanëve të grupeve etnike, të cilët janë larguar nga lufta civile në Sudan. Ata kanë humbur shtëpitë e tyre, familjarë dhe mjetet e jetesës. Tani ata

po përballojnë jetën në kampe refugjatësh, si ai në Jida, në Sudanin Jugor, ku marrin vetëm ndihmat thelbësore përmes organizatave të ndryshme humanitare.

Mes këtyre refugjatëve, ka disa që ndjekin

Jezusin. Ata kanë formuar grupe të vogla miqësore brenda kampeve dhe synojnë të arrijnë me Ungjillin të bashkatdhetarët e tyre myslimanë. Drejtuesit e kishës lokale kanë një qëllim që të përfshijnë të 70 grupet etnike në kampin e Jidës. Një nga sfidat më të mëdha është që shumica e njerëzve në kamp flasin gjuhë të pashkruara. Vetëm shumë pak nga refugjatët dinë shkrim e këndim. Prandaj ata nuk kanë as Bibla të përkthyer gjithashtu.

Por Jezusi i mësoi njerëzit me histori dhe shëmbëlltyra. Duke ndjekur shëmbëllin e Tij, besimtarë të motivuar janë trajnuar të tregojnë përmbajtjen e Biblës në mënyra emocionuese dhe t'u përgjigjen pyetjeve të bashkatdhetarëve të tyre myslimanë. Dhe Zoti po punon! Myslimanët po dëgjojnë për Jezusin për herë të parë dhe po bëhen ndjekësit e Tij. Në këtë mënyrë, koha e shpenzuar në kampin Jida kthehet në një mundësi unike për të bërë të njohur Ungjillin te këta refugjatë myslimanë. Nëse ata kanë mundësinë të kthehen përfundimisht në vendet e tyre prejardhëse, këta besimtarë të rinj do ta marrin Lajmin e Mirë me vete tek ata që qëndruan atje.

LE TË LUTEMI

- ◆ Për këta besimtarë të rinj që të rriten në unitet, të inkurajojnë njëri-tjetrin në miqësi dhe dashuri dhe të jenë një dritë në kampin Jida.
- ◆ Për siguri në kampe dhe për administrim të mirë të burimeve humanitare, në mënyrë që të plotësohen nevojat e refugjatëve.
- ◆ Për paqe në rajon në mënyrë që këta refugjatë të mund të kthehen në shtëpitë e tyre në malet Nuba dhe që besimtarët përreth tyre të marrin Ungjillin atje.



Nata e fuqisë: kapësit e ëndrrave

Nata e 27-të e ramazanit quhet *'Laylat Al Qadr'*, që përkthehet si "Nata e madhe ose e çmuar". Njihet gjithashtu si "Nata e fuqisë" ose "Nata e Kadrit".

Laylat Al Qadr' ishte nata e parë e zbulësës së Kur'anit të Shenjtë ndaj profetit Muhamed nga kryengjëlili Jibrail (Gabriel) dhe myslimanët e mbajnë këtë si ngjarja më e rëndësishme në histori. Në këtë natë, myslimanët kalojnë shumë kohë në lutje dhe adhurim, sepse mendohet se lutjet e ofruara në këtë natë vlejné sa të gjitha lutjet e një mijë muajve dhe shumë myslimanë presin që në këtë natë të dëgjojnë nga Zoti përmes ëndrrave.

Myslimanët shpesh japin dëshmi për rolin e ëndrrave në jetën e tyre. Kith është një punonjës në botën myslimane, që dëgjon shpesh histori nga myslimanë, të cilët në ëndërr shohin një "qenie të dritës". Një prej tyre është një shofer taksie me emrin Ahmed.

"Çfarë ëndrrash ke pasur?" – e pyeti Kithi Ahmedin. Sytë e Ahmedit shndritën nga pyetja. "Kam pasur vazhdimisht këtë ëndërr, - tha ai, "të një burri që shkëlqen si dielli.

Nuk ia dalloja dot fytyrën, por ai zgjatej drejt meje me dashuri."

Kithi mori nga çanta e tij një Testament të Ri në gjuhën Urdu dhe e hapi te Mateu 17. "A mund të lexosh 2 vargjet e para?" – e pyeti ai Ahmedin. "Mendoj se do të jenë interesante për ty."

Ahmedi mori librin dhe lexoi vargjet hyrëse: "Mbas gjashtë ditësh Jezusi mori me vete Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin, vëllanë e tij, dhe i çoi mbi një mal të lartë, në vetmi; dhe u shpërfytyrua përpara tyre: fytyra e tij shkëlqeu si dielli dhe rrobat e tij u bënë të bardha si drita." (Mateu 17:1-2)

Ahmedi ngriti sytë nga Kithi, sytë e tij plot habi. "Ky është burri," – tha ai, "burri në ëndrrat e mia. Kush është ky?"

Kithi kishte mësuar që këto ëndrra janë një mënyrë se si Fryma e Shenjtë zbulon Jezusin të myslimanët. Sonte, le të lutemi për më shumë ëndrra që zbulojnë Atë.

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni për myslimanët në këtë Natë fuqie, që Zoti të zbulojë Vetën e Tij tek ata në shumë mënyra.
- ◆ Lutuni që ëndrrat për Jezusin të inkurajojnë myslimanët anë e mbarë botës që të mësojnë më shumë për Të.

- ◆ Lutuni për besimtarë që mund të ndihmojnë myslimanët të kuptojnë kush është "qenia e dritës" në ëndrrat e tyre dhe se si Ai dëshiron që ata ta ndjekin Atë.

“

Myslimanët shpesh japin dëshmi për rolin e ëndrrave në jetën e tyre.

”

Urat e Perëndisë: përkthimet e shprehjeve myslimane

Ashtu si krishtërimi, edhe islami është një fe që kërkon të konvertojë të gjithë njerëzit. Gjithsesi, islami sfidohet këtu nga lidhjet e tij me kulturën arabe të shekullit të 7-të, në të cilën u themelua dhe në besimin se libri i tij i shenjtë mund të lexohet saktë vetëm në arabisht.

Krishtërimi e përkthen veten në kultura dhe gjuhë lokale të njerëzimit, duke pasur të njëjtën qasje si Jezusi që e përktheu Vetën në formën njerëzore lokale. Në këtë mënyrë, komunitete të krishtera janë rritur përreth botës duke përfshirë shumë shprehje dhe gjuhë të ndryshme kulturore. Perëndia thirret me një mijë emra të ndryshëm, të cilët vijnë me kuptimin që gjendet në Biblën e përkthyer, e cila u zbulon njerëzve të asaj gjuhe se “është një Zot i vetëm, një besim i vetëm, një pagëzim i vetëm” (Efes. 4:5), që ne të gjithë ndajmë. Ndërsa Ungjilli po përkthehet besnikërisht në çdo gjuhë mbi dhe, ai mbetet i vetmi besim “që u qe trasmetuar shenjtoreve një herë e përgjithmonë” (Juda 3).

Sot, disa të krishterë nuk kanë mbështetur përkthimin besnik të Biblës, ku Emri i Zotit njihet si “Allah”. Apologë të njohur kanë

argumentuar që Allah është në fakt një zot tjetër. Disa kanë thënë se fjala “Allah” e ka zanafillën nga një perëndeshë hebre në Babiloni. Të tjerë argumentojnë se “Allah” lidhet me fjalën e lashtë semitike

Çdo lëvizje e myslimanëve në besimin te Krishti sot, ka ndodhur në të njëjtën kohë dhe si përkthim i Biblës në gjuhën lokale.

për Perëndinë, “Elohim”. Sidoqoftë, është e qartë që myslimanët nuk adhurojnë një perëndeshë hebre, dhe as që e pranojnë se ekziston. Më i rëndësishëm është fakti që të krishterët arabë kanë adhuruar Perëndinë si “Allah” që përpara se të lindte Muhamedi. Të krishterët arabë, dhe në fakt disa komunitete të mëdha gjuhësore si Hauza në Afrikën Perëndimore (35 milion) dhe indonezianët e Indonezisë (250 milion), vazhdojnë ta

përdorin emrin “Allah” vetëm kur i referohen Zotit të Biblës. Ata e kuptojnë, ashtu si çdo besimtar duhet, që rëndësia e emrave qëndron në zbuluesin e shenjtë të Biblës që i jep kuptimin.

Çdo lëvizje e myslimanëve në besimin te Krishti sot, ka ndodhur në të njëjtën kohë dhe si përkthim i Biblës në gjuhën lokale. Përkthyesit i quajnë këto përkthime lokale në komunitetet myslimane si “Përkthimet e shprehjeve myslimane”.

E bukura e besimit të krishterë është që përkthehet në kultura dhe gjuhë lokale. Ne duhet të ngazëllem që Perëndia ka zgjedhur të zbulojë Vetën e Tij të secili grup njerëzish në kulturat dhe gjuhët e tyre lokale. Ajo çka nuk ndryshon në përkthim është kuptimi i Fjalës së Zotit.

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni për vazhdimësinë e përkthimit të Biblës në gjuhët lokale myslimane që të gjithë myslimanët të kuptojnë mesazhin e Ungjillit.
- ◆ Lutuni për unitet mes të krishterëve që punojnë për të ndarë të vërtetën e Ungjillit me botën myslimane.
- ◆ Lutuni që myslimanët jo arab të kuptojnë që nuk kanë pse të braktisin gjuhën dhe kulturën e tyre në mënyrë që t'i afrohen Zotit dhe të adhurojnë Zotin e gjithë krijimit.

Ura të Perëndisë: Institucione dhe lëvizje

Në vitin 1884, Franca ndërtoi katedralen e mrekullueshme në Carthage të Tunizisë. Ishte presupozuar të ishte spiranca e Krishtërit në Afrikën e Veriut për 100 vjet. Por, njëqind vjet më vonë, adhurimi në katedrale kishte ndaluar dhe ndërtesa kishte marrë një emër të ri dhe përdorej për koncerte dhe veprimtari sociale.

Jo të gjithë të krishterët kanë arritur të kuptojnë se nuk është ndërtesa ajo që bën lëvizjen . Dhe , nuk do të thotë se mungesa e ndërtesave “të krishtera” është një tregues se nuk ka një lëvizje për Krishtin që është duke u zhvilluar.

Në një vend fqinj të Afrikës së Veriut , unë isha duke intervistuar besimtarë me prejardhje myslimane , në një ndërtesë të thjeshtë kisha. Këta dhjetra pleq ishin mbledhur për të më treguar mua historitë e tyre me Krishtin dhe se si Ungjilli po përhapej në tokën e origjinës së tyre në Afrikën e Veriut. Humbja e

katedrales së madhe nuk ka penguar aspak në kthimin në Krishtin të mijëra njerëzve në këtë zonë.

Sipërmarrja e misionit të Krishterë për shumë gjatë ka sjellë konfuzion me ndërtimin e ndërtesave

kishtare, spitaleve dhe shkollave ,përkundrejt ndërtimit të Mbretërisë së Perëndisë.Në fakt, Mbretëria e Perëndisë ndërtohet në zemrat e burrave dhe grave të cilët kanë

nënshtruar jetët e tyre Zotit Jezus Krisht. Ne shohim Mbretërinë e Perëndisë të përparojë kur mesazhi i Jezusit transformon jetët e njerëzve , të cilët pasi kanë marrë shpëtimin e ndajnë këtë të vërtetë me njerëz të tjerë, të cilët më pas mblidhen së bashku për përbashkësi dhe për studimin e Fjalës së Perëndisë. Ndërtesat thjesht do ta pasojnë këtë gjë.

Ungjilli është duke u përhapur në Afrikën e Veriut në të njëjtën mënyrë si u përhap në perandorinë Romake. Ndërtesat, katedralet, spitalet dhe universitetet do të pasojnë lëvizjen e Perëndisë, por nuk do të jenë asnjëherë përpara saj.

LE TË LUTEMI

- ◆ Lutuni që të Krishterët do të shohin Mbretërinë e Perëndisë si komunitete besimtarësh të rilindur.
- ◆ Lutuni që të Krishterët do të investojnë burimet e tyre në shpalljen e Ungjillit dhe në dishepullizim më shumë se në ndërtimin e ndërtesave dhe institucioneve.
- ◆ Lutuni për lëvizje të gjalla besimi në Afrikën e Veriut dhe përmes Shtëpisë së Islamit të cilat po përhapen nga personi në person nga mijëra njerëz.



Po tani, çfarë? Hapa praktikë për të dashur myslimanët

Të krishterët shpesh pyesin, “ Si mund të jem pjesë e asaj që Zoti është duke bërë mes Myslimanëve në ditët e sotme ?” Përgjigja është e thjeshtë, “Duajini Myslimanët.”

E thjeshtë , e megjithatë shumë e vështirë për t’u arritur. Islami e ka bërë veten një prej feve më të frikshme në tokë.Ky reputacion vjen nga një histori e gjatë pushtimesh, konvertimeve të detyruara, diskriminimit si dhe veprave të terrorizmit që mediat shfaqin në ditët e sotme. Është një pikëpamje e mbajtur nga Hindutë, Kinezët, Socialistët dhe Budhistët.Islami, e ndan veten nga çdo person jo-mysliman mbi tokë.

Megjithatë myslimanët nuk janë Islam. Ata janë njerëz, burra dhe gra,djem dhe vajza. Për shekuj me rradhë, myslimanët në shumë vende të botës janë izoluar në komunitete të cilat u mësojnë stereotipe rreth të Krishterëve –që ata janë injorantë, ecin sipas botës dhe janë mëkatarë.Ky stereotip duhet të sfidohet!

Një emigrant me prejardhje myslimane

nga Irani,i quajtur Ali, kohët e fundit më tregoi historinë e tij. “Një mik I Krishterë më ftoi në një darkë të përjavëshme që ata bënin në kishën e tij,” tha ai. “ Në momentin që mora vesh se do të gatuanin mish derri në zgarë, menjëherë refuzova kërkesën e mikut tim. Dy javë më vonë, Ali mori një tjetër ftesë. Këtë herë, kisha, kishte hequr nga menuja çdo ushqim që Ali mos të kundërshtonte dhe vetëm që ai të merrte pjesë në darkë. “ Kur e mora vesh se çfarë kishin bërë vetëm që unë të isha në mes tyre, nuk mund të refuzoja”, tha Ali.

Vetëm në pak javë, Ali arriti të njohë shumë besimtarë, të cilët ndanin me të,dashurinë e Krishtit. Sot, Ali është një ndjekës I Jezus Krishtit. Ai përdor çdo mundësi për të ndarë besimin e tij si dhe inkurajon të krishterët të tregojnë dashuri ndaj myslimanëve, si e vetmja rrugë për t’i sjellë ata në besimin e krishterë.

Mund të jemi të tunduar që të kemi frikë, t’ja mbathim apo edhe të luftojmë myslimanët. Por nëse bëjmë kështu , vetëm do të përforcojmë për ta idenë se



të Krishterët janë “ të tjerët” që duhet të sfidohen dhe prej të cilëve duhet të shmingen.

Rruga më e drejtpërdrejtë për t’i dashur myslimanët, është t’i duam ata. Kur ne lutemi, ne kuptojme zemrën e Perëndisë. Perëndia I do myslimanët kaq shumë sa Ai dërgoi Birin e Tij të

vetëmlindur, për t’i falur dhe për t’i shpëtuar.Ndërsa ne lutemi për myslimanët, ne zbulojmë se zemrat tona fillojnë të ndryshojnë. Ne fillojmë t’i shohim ashtu siç Perëndia I sheh.Ata nuk janë një kërcënim I fshehtë me disa ideologji të rrezikshme . Ata janë burra dhe gra, djem dhe vajza, të cilët janë të humbur- ashtu sikurse ishim edhe ne – dhe në nevojë të dëshpërueshme për Shpëtimtarin.

**“ Dhe mos u konformoni me këtë botë,
por transformohuni me anë të ripërtëritjes
së mendjes suaj , që të provoni cili është I
miri , I pëlqyeri dhe I përsosuri
vullnet i Perëndisë.”**

Romakëve 12:2

Vazhdoni të luteni përgjatë gjithë vitit:

Kur ju dëgjoni në lajme për dhunë apo padrejtësi që ka lidhje me myslimanët, ndaloni dhe lutuni për burrat dhe gratë të cilët janë peng të këtyre gjërave. Lutuni për ata që i shkaktojnë, si dhe për ata që janë viktimat.

- ♦ Lutuni që Perëndia do t'ju drejtojë ju tek myslimanët të cilët të mund t'i doni në emrin e Jezusit.
- ♦ Lutuni për të Krishterët e rinj që t'i rezistojnë tundimit për të qenë sy për sy e, dhëmb për dhëmb. Kërkojini Perëndisë që t'ju japë dashurinë e Tij për myslimanët.

“Dhe për këtë lutem që dashuria juaj të teprojë gjithnjë e më shumë në njohuri dhe në çdo dallim.”

Filipianëve 1:9





"30 ditët", Shqipëri
Kutia Postare 119,
AEP 33, Tiranë
ywamalbania@gmail.com
<http://www.ywamalbania.com/>



WWW.PRAY30DAYS.ORG

© Copyright 2016